

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.10 197, datë 10.12.2009

PËR FONDET E PENSIONIT VULLNETAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të vendosë standardet e nevojshme për:

a) administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;

b) mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;

c) nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit;

ç) licencimit dhe mbikëqyrjes së shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të të gjitha çështjeve të lidhura me to.

Neni 3

Autoriteti përgjegjës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Asete” janë letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese apo të depozitarit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

b) “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c) “Administrator” është personi fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese në shoqëri, i cili është drejtori ekzekutiv ose punon nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv.

ç) “Agjent i fondit të pensionit” është një person i licencuar nga autoriteti, i cili nuk është punonjës i shoqërisë administruese dhe, në bazë të tagrave të dhëna nga shoqëria administruese, bën marketing, lidh kontrata të fondit të pensionit, në emër të shoqërisë administruese të licencuar.

d) “Anëtar” është personi fizik, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit në bazë të kontratës së tij, të fondit të pensionit, me shoqërinë administruese, në masën e zotërimit të kuotave.

dh) “Aksionar ndikues” është çdo person që ushtron të drejta ose ka kontroll efektiv mbi aksionet, që përfaqësojnë 5 për qind ose më shumë të kapitalit të aksioneve në shoqëri ose që i jep atij 5 për qind ose më shumë të totalit të së drejtës së votës në shoqëri.

e) “Auditues i jashtëm” është shoqëria e auditimit.

ë) “Bankë” është një institucion i licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer veprimtari bankare dhe financiare, në përputhje me legjislacionin bankar në fuqi.

f) “Depozitar” është banka e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit.

g) “Fond pensioni vullnetar”, në vijim “fond pensioni”, është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit.

gj) “Fond pensioni profesional” është fondi i pensionit, për të cilin punëdhënësi ka kontraktuar me shoqërinë administruese, për t’u ofruar punonjësve të vet një plan

pensioni profesional.

h) “Fitim nga kapitali” janë të ardhurat nga diferenca e çmimit të aseteve.

i) “Këshill i administrimit” është organi i vetëm i shoqërisë administruese me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

j) “Kontribues” është anëtari në një fond pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, i cili paguan kontributet e pensionit në llogarinë e pensionit të anëtarit të fondit të pensionit.

k) “Kontrollues kryesor” është çdo person fizik, pavarësisht nëse është me kombësi shqiptare ose jo, i cili ushtron ndikim tek i licencuari, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një pale të tretë. Këtu përfshihet pa kufizim çdo person, në bazë të drejtimit ose udhëzimeve të të cilit veprojnë drejtorët e shoqërisë dhe mendimet e të cilit ndikojnë në procesin vendimmarrës të të licencuarit.

l) “Kuotë pensioni” është pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aseteve të fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të aseteve të fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të fondit të pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të këtij fondi pensioni.

ll) “Kthim nga investimi” është rezultati, që merret nga investimi i aseteve dhe fitimi i kapitalit.

m) “Letra me vlerë” janë titujt dhe instrumentet financiare derivate, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore në fuqi.

n) “Ligj i shoqërive tregtare” është sipas dispozitave ligjore në fuqi.

nj) “I licencuar” është çdo person i licencuar sipas këtij ligji.

o) “Institucion financiar” është shoqëria e administrimit të portofolit dhe shoqëria e sigurimit të jetës.

p) “Përfitime” janë pagesat në para, në formë pensioni, të shumave, që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit.

q) “Punëdhënës” janë tregtari, personat juridikë, përfshirë institucionet shtetërore, institucionet e financuara nga Buxheti i Shtetit dhe institucionet e pavarura.

r) “Plan pensioni” është kontrata ndërmjet individit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit, të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen individit, i cili, me pëlqimin e vet, bëhet anëtar i fondit të pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

rr) “Plan pensioni profesional” është kontrata ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit, të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen punëmarrësit, i cili, me pëlqimin e vet, bëhet anëtar i fondit të pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

s) “Person” është personi fizik ose juridik, ku përfshihet një individ, shoqëri, një organ i administratës shtetërore dhe çdo strukturë tjetër, që njihet si person juridik i veçantë.

sh) “Palë e lidhur” është personi fizik ose juridik, që ka lidhje me shoqërinë administruese për shkak se është:

i) pjesëtar i këshillit të administrimit ose i punësuar nga shoqëria;

ii) pjesëtar i auditit të brendshëm të shoqërisë;

iii) aksionar ndikues i shoqërisë;

iv) kontrollues kryesor i shoqërisë;

v) bashkëshortja ose një i afërm, deri në radhë të tretë, i një anëtarit të këshillit të administrimit ose auditit të brendshëm, i aksionarit ndikues, i kontrolluesit kryesor të

shoqërisë, apo punonjës i shoqërisë ose administratori i veçantë i shoqërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

vi) person, që ka të drejtë të marrë vendime ose që ndikon në vendimet e shoqërisë, në bazë të një kontrate apo mbi çdo bazë tjetër.

t) “SNRF” janë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

th) “Shoqëri administruese e fondit të pensionit vullnetar”, në vijim “shoqëri administruese”, është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe e licencuar nga autoriteti, për të administruar një ose disa fonde të pensionit.

u) “Transferim i asetëve” është transferimi i asetëve nga një fond pensioni te një fond tjetër pensioni.

KREU II

FONDI I PENSIONIT

Neni 5

Forma ligjore e fondit të pensionit

1. Fondi i pensionit është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, i përbërë nga kontributet dhe investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat. Fondi i pensionit zotërohet bashkërisht nga disa persona, në pronësi të ndarë dhe ku pjesët e pronësisë përfaqësohen nga kuota në fondin e pensionit. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë e pjesës përpjesëtimore të asetëve, të cilat ndodhen në fondin e pensionit. Administrimi i fondit të pensionit kryhet nga shoqëria administruese në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit dhe synon rritjen e asetëve të këtyre të fundit. Investimi i fondit të pensionit bëhet në përputhje me dispozitat e kontratës së fondit të pensionit.

2. Kur asetet e fondit të pensionit janë të lidhura me të drejta dhe detyrime të tilla, si e drejta e votës, shoqëria administruese përfaqëson të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga këto asetë, përpara palëve të treta. Shoqëria administruese, gjatë ushtrimit të së drejtës së votës apo të të drejtave të tjera, që lidhen me asetet e fondit të pensionit, udhëhiqet vetëm dhe ekskluzivisht nga interesi më i mirë i anëtarëve të fondit të pensionit.

3. Emri i fondit të pensionit përmban fjalët “Fond i pensionit vullnetar” dhe asnjë person ose subjekt tjetër, përveçse një fond i pensionit vullnetar, i miratuar nga autoriteti për të përdorur këtë emër, nuk mund ta përdorë këtë emër ose ndonjë terminologji tjetër, që e bën një individ të besojë se ky është fond i pensionit vullnetar.

Neni 6

Kontrata e fondit të pensionit

1. Shoqëria administruese përgatit kontratën tip të fondit të pensionit për secilin nga fondet e pensionit që administron. Kjo kontratë përdoret për të gjithë anëtarët në një

fond pensioni. Çdo ndryshim i kontratës së fondit të pensionit duhet të nënshkruhet nga anëtarë dhe është i vlefshëm vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) strategjia e investimeve, e përshkruar në kontratën e fondit të pensionit për fondin e pensionit, nuk mund të ndryshohet, përveçse, në raste të argumentuara, me miratim të autoritetit;

b) ndryshimet e elementeve të radhitura nga shkronja “b” deri te shkronja “gj” e pikës 2 të këtij neni mund të kryhen vetëm me miratimin e autoritetit.

2. Kontrata e fondit të pensionit përfshin ose përshkruan me hollësi:

a) strategjinë e investimeve, që do të zbatohet për fondin e pensionit, që përfshin një listë asetesh, ku mund të investohet ky fond;

b) të gjitha tarifavat, shpërblimet dhe çdo lloj të ardhure që merret nga fondi i pensionit dhe i transferohet shoqërisë administruese, depozitarit dhe çdo personi tjetër, përfshirë një listë të plotë të kostove të tjera, që do të mbulojnë nga asetet e fondit të pensionit dhe mënyrat e përlllogaritjes së tarifave, shpërblimeve dhe të ardhurave;

c) kushtet dhe procedurat për anëtarësimin, pezullimin e anëtarësimit, transferimin në një fond tjetër pensioni, tërheqjen nga fondi i pensionit dhe mënyrën e pagesës pas daljes në pension. Kontrata duhet të përfshijë një përshkrim të procedurës së zbatueshme për transferimin e asetëve në një fond pensioni, kur shihet e përshtatshme;

ç) të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të fondit të pensionit, përfshirë madhësinë, mënyrat e pagesës së kontributeve në fondin e pensionit, procedurat e pagesave të të ardhurave të pensionit dhe moshën e caktuar për përfitimin e pensionit;

d) rregullat për të llogaritur vlerën neto të asetëve të fondit të pensionit, përfshirë detyrimet e shoqërisë administruese për të raportuar tek anëtarët e fondit të pensionit të vlerës neto të asetëve të kursimeve të tyre në fondin e pensionit;

dh) detyrimin e shoqërisë administruese për të raportuar tek anëtarët e fondit të pensionit për mbarëvajtjen e fondit të pensionit dhe detyrimin për të njoftuar anëtarët e fondit të pensionit për çështje të tjera;

e) procedurën e konvertimit të kontributeve të pensionit në kuota, rregullat për përlllogaritjen e kuotave në përpjesëtim me shumën në llogarinë e anëtarëve të fondit të pensionit dhe për konvertimin e kuotave në para e për pagesën e parave anëtarëve të fondit të pensionit;

ë) kushtet dhe procedurat për lidhjen, ndryshimin dhe përfundimin e kontratës së fondit të pensionit, ndërmjet anëtarëve të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese;

f) të drejtat e anëtarëve të fondit të pensionit për të kërkuar transferimin e asetëve të tyre nga një fond në një tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese apo nga një shoqëri tjetër administruese dhe procedurën për këtë transferim, përfshirë edhe kostot e lidhura me të;

g) përshkrimin e kontratës ndërmjet shoqërisë administruese dhe depozitarit, përfshirë të drejtat e anëtarëve, sipas kësaj kontrate dhe një deklaratë, e cila të tregojë se depozitari është dhe do të vazhdojë të mbetet tërësisht i pavarur nga shoqëria administruese dhe nga çdo palë tjetër, që ka lidhje me shoqërinë administruese;

gj) procedurën për amendimin e kontratës të fondit të pensionit.

3. Kontrata e fondit të pensionit duhet të shkruhet në gjuhë të kuptueshme dhe të paraqitet në formë të thjeshtë.

Neni 7

Prospekti

1. Shoqëria administruese, përpara se të fillojë promovimin e fondit të pensionit dhe lidhjen e kontratës së fondit të pensionit me çdo person dhe jo më vonë se 31 marsi i çdo viti duhet të publikojë një prospekt, i cili përmban informacion të vërtetë dhe korrekt për fondin e pensionit që administrojnë. Informacioni duhet të përditësohet.

2. Shoqëria administruese vë në dispozicion të çdo personi të interesuar prospektin, gjatë kohës që bën marketingun për pjesëmarrje në njërin nga fondet e saj të pensionit. Shoqëria administruese dhe agjentët e fondit të pensionit nuk do të lidhin kontratë fondi të pensionit me asnjë person, pa i vënë më parë në dispozicion një kopje të prospektit.

3. Prospekti i bashkëlidhet kontratës së fondit të pensionit.

Neni 8

Përmbajtja e prospektit

1. Prospekti përmban një përshkrim dhe një grafik, që paraqet organizimin, detyrat dhe të drejtat e anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese dhe të depozitarit.

2. Prospekti përmban informacionin e nevojshëm, në mënyrë që anëtarët potencialë të jenë në gjendje, në bazë të informacionit, të bëjnë një gjykim rreth investimit të propozuar dhe, në veçanti, të risqeuve që shoqërojnë këtë investim.

3. Prospekti përmban informacion për funksionimin e skemës me kontribute të përcaktuara dhe mbajtësin e riskut të investimit.

4. Prospekti jep një shpjegim të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm të strategjisë së investimit të fondit të pensionit, të profilit të shpërndarjes së riskut të fondit të pensionit dhe, në veçanti, përshkruan riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e agjencisë, që shoqëron fondin e pensionit.

5. Prospekti përmban informacionin e mëposhtëm për shoqërinë administruese:

a) emrat dhe kualifikimet e aksionarëve ndikues të saj dhe të këshillit të administrimit;

b) përshkrim të plotë të kostove dhe tarifave që i duhen paguar shoqërisë administruese, duke i zbritur nga asetet e fondit të pensionit e të çdo kostoje tjetër, të mundshme, si dhe shembuj të përlllogaritjeve se si këto kosto dhe tarifa do të pakësojnë vlerën e kthimit të investimit për anëtarin.

6. Prospekti paraqet informacion të verifikuar nga një aktuar i autorizuar për shumat, që duhet të investojë një anëtar në bazë vjetore në një fond pensioni, në mënyrë që të përfitojë një pension të përshtatshëm, kur të arrijë moshën e caktuar të pensionit. Shpjegimet duhet të shoqërohen me shembuj, të cilët tregojnë skenarë të ndryshëm për moshë të ndryshme dhe se si ndryshimi i moshës ndikon në shumën, që do të derdhet si kontribut.

7. Këshilli i administrimit mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e prospektit.

Neni 9

Miratimi i kontratës së fondit të pensionit dhe i prospektit

1. Shoqëria administruese paraqet pranë autoritetit një kërkesë për miratim të projektkontratës së fondit të pensionit dhe të projektprospektit për çdo fond pensioni. Autoriteti shqyrton kërkesën, që shoqëron projektkontratën e fondit të pensionit dhe projektprospektin dhe kontrollon nëse këto projekte janë në përputhje me këtë ligj, si në formë dhe në përmbajtje.

2. Shoqëria administruese ka të drejtë të përdorë vetëm kontratën e fondit të pensionit dhe prospektin, të miratuara nga autoriteti. Prospekti duhet të dërgohet çdo vit për miratim në autoritet. Çdo ndryshim i sjellë në prospekt gjatë periudhës njëvjeçare miratohet nga autoriteti.

3. Autoriteti miraton ose refuzon kërkesën për miratimin e kontratës së fondit të pensionit dhe prospektit brenda 45 ditëve pune nga data e marrjes së paketës së plotë të dokumenteve të kërkuara. Data e miratimit nga autoriteti të kontratës dhe prospektit është data e miratimit të fondit të pensionit. Nëse projektkontrata e fondit të pensionit dhe/ose projektprospekti nuk miratohen nga autoriteti, shoqëria administruese ka të drejtë të ridorëzojë paketën përkatëse për miratim, pasi të jenë bërë ndryshimet e nevojshme.

4. Autoriteti mund të nxjerrë rregulla më të hollësishme për përmbajtjen e kontratës së fondit të pensionit e të prospektit dhe të parashikojë kërkesa e rregulla shtesë, që kanë të bëjnë me procedurën e miratimit të projektkontratës së fondit të pensionit dhe të projektprospektit, të paraqitura nga shoqëria administruese.

Neni 10

Regjistri i fondeve të pensionit

1. Autoriteti mban regjistrin e fondeve të pensionit. Regjistri i fondeve të pensionit vihet në dispozicion të publikut.

2. Regjistri i fondeve të pensionit përmban informacion të përditësuar për emrin e fondit të pensionit, llojin e fondit të pensionit, numrin dhe datën e vendimit të miratimit të fondit të pensionit, të dhëna për shoqërinë administruese, që e administrojnë, të dhëna për depozitarin, të dhëna të tjera, që lidhen me veprimtarinë e fondit të pensionit. Autoriteti nxjerr rregullore për kërkesat e veçanta për përmbajtjen e regjistrit të fondeve të pensionit.

Neni 11

Pjesëmarrja në një fond pensioni

1. Çdo individ mund të bëhet anëtar në një fond pensioni, vetëm pasi të ketë lidhur një kontratë fondi pensioni me shoqërinë administruese.

2. Përpara nënshkrimit të kontratës së fondit të pensionit, shoqëria administruese duhet të sigurohet se individ, i cili dëshiron të bëhet anëtar, e ka kuptuar që ky është

investimi i duhur dhe është i informuar hollësisht për risqet, që lidhen me investimin në fondin e pensionit dhe se risku i agjencisë, risku i kredisë, risku i tregut dhe çdo risk tjetër, që shoqëron investimin në fondin e pensionit, është shpjeguar qartë.

3. Pjesëmarrja në fondin e pensionit vullnetar nuk përjashton detyrimin e personave për t'u siguruar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Kontributet në fondin e pensionit

1. Asetet e anëtarit në një fond pensioni përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të anëtarit dhe nga kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Nëse anëtari, përkohësisht ose përgjithmonë, pushon së kontribuari në fondin e pensionit, ai mbetet anëtar në fondin e pensionit dhe ka të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit.

3. Grupi i aseteve të fondit të pensionit është në pronësi vetëm të anëtarëve të fondit.

4. Shoqëria administruese konverton në kuotë pensioni kontributet e investuara në fondin e pensionit dhe asetet e transferuara. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilën nga asetet e fondit të pensioneve. Vlera totale e kuotave në fondin e pensionit është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të fondit të pensionit.

5. Kontributet dhe asetet e transferuara të fondit të pensionit mund të këmben me nënndarje të kuotave të pensionit dhe vlera e aseteve, në llogarinë e anëtarit, mund të shprehet me këto nënndarje të kuotave të pensionit, por jo në më shumë se 4 shifra pas presjes dhjetore.

Neni 13

Mbrojtja e aseteve të anëtarit

1. Është absolutisht e pavlefshme çdo përpjekje për të lënë si garanci ose për të përdorur për qëllime të ngjashme asetet në llogarinë e pensionit të anëtarit të fondit të pensionit ose për t'i bërë objekt ekzekutimi apo pjesë të falimentimit të mundshëm.

2. Asetet e fondit të pensionit nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruese të fondit të pensionit.

3. Fondi i pensionit nuk mund të jetë pjesë e procedurës së falimentimit.

Neni 14

Përlllogaritja e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit

1. Shoqëria administruese, në periudha të rregullta kohore dhe të paktën çdo 30 ditë, duhet të informojë çdo anëtar për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aseteve në llogarinë e pensionit të anëtarit, datat e kontributeve dhe transferimet e

aseteve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve e të aseteve në kuota pensioni. Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit për çdo anëtar, në përputhje me dispozitat e nenit 46 të këtij ligji. Mënyrat e lejuara të informimit janë me shkrim dhe elektronike.

2. Përlllogaritja e vlerës neto të aseteve të anëtarit në një fond pensioni, për qëllime të sigurisë së likuiditetit, do të kryhet në bazë të parimit të “vlerës së tregut”, ndërsa asetet më pak likuide do të vlerësohen duke ndjekur parimet e zbatueshme të SNRF-së, përveçse kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e nxjerra nga autoriteti.

3. Autoriteti nxjerr rregullore për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit, si dhe për afatet e publikimit të informacionit, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 15

Transferimi i aseteve të anëtarit në një fond tjetër pensioni

1. Anëtari ka të drejtë që, në çdo kohë, të transferojë asetet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese.

2. Nëse anëtari në një fond pensioni, “fond i mëparshëm i pensionit”, vendos të bashkohet me një tjetër fond pensioni, “fondi i ri i pensionit”, ai duhet të njoftojë shoqërinë administruese, që administron fondin e mëparshëm të pensionit, që ai ka vendosur të transferojë asetet e veta në një tjetër fond pensioni, me të njëjtën shoqëri administruese ose, që ka lidhur një kontratë fondi pensioni me një shoqëri tjetër administruese dhe që shuma në llogarinë e tij, pasi të jenë bërë zbritjet përkatëse, në përputhje me kontratën e fondit të pensionit, duhet të transferohet në fondin e ri të pensionit.

3. Anëtari, që ka vendosur të transferojë asetet e veta në një fond të ri pensioni, duhet të njoftojë shoqërinë administruese të fondit të mëparshëm të pensionit se kontrata me këtë shoqëri administruese do të përfundojë dhe se asetet e tij duhet të transferohen në fondin e ri të pensionit, në kohën e caktuar, siç është rënë dakord. Transferimi i aseteve në fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas dhjetë ditësh pune, pasi shoqëria administruese e fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga anëtari.

Neni 16

Pagesa e Pensionit

1. Anëtari i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere:

a) kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar;

b) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në

përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shoqëria administruese mund t'i propozojë anëtarit t'i investojë asetet e tij në produkte të tjera financiare, para se të kryejë pagesën te ky anëtar, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, por duhet t'i shpjegojë qartë dhe me shkrim se ai ka të drejtën e pakushtëzuar për të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta në fondin e pensionit. Autoriteti nxjerr rregullore për mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit.

Neni 17

Tërheqja e parakohshme

1. Tërheqja e aseteve nga llogaria individuale e fondit të pensionit, përpara plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 16 të këtij ligji quhet tërheqje e parakohshme.

2. Tërheqja e parakohshme shoqërohet me penalitete, që llogariten në raport me kohën e përmbushur nga anëtari nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme.

3. Autoriteti nxjerr rregullore për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit.

Neni 18

Kur anëtari vdes para moshës së pensionit

Nëse anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta, sipas përcaktimit të bërë në nenin 16 të këtij ligji, asetet në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë.

KREU III

SHOQËRIA ADMINISTRUESE

Neni 19

Funksionet dhe parimet e shoqërisë administruese

1. Funksionet kryesore të shoqërisë administruese janë mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikim), për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit. Shoqëria administruese, gjithashtu, mund të ketë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit.

2. Shoqëria administruese, gjatë pranimit të anëtarëve të rinj dhe administrimit të aseteve të fondit të pensionit, vepron në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe profesionale, në përputhje me interesin më të mirë të anëtarit ose të anëtarëve të mundshëm. Ajo siguron se çdo këshillë për investim vlerësohet e përshtatshme përpara se t'i jepet anëtarit ose anëtarëve të mundshëm.

3. Shoqëria administruese ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme në administrimin e aseteve të fondit të pensionit, përfshirë, të paktën, çmimin e realizimit, koston, shpejtësinë, probabilitetin e realizimit dhe probabilitetin e shlyerjes, si dhe çdo faktor tjetër, të vlerësuar të nevojshëm për administrimin e aseteve të fondit të pensionit.

Neni 20

Struktura ligjore

1. Shoqëria administruese themelohet si shoqëri aksionare, me kohëzgjatje të pakufizuar, ku të paktën 51 për qind e aksioneve ose e së drejtës së votës zotërohen nga banka ose institucione financiare. Organizimi i saj bëhet sipas sistemit me një nivel drejtimi, sipas ligjit të shoqërive tregtare. Shoqëria administruese duhet ta ketë selinë në Shqipëri dhe nuk mund të jetë degë e një shoqërie të huaj.

2. Veprimtaria e vetme e një shoqërie administruese është administrimi i fondit të pensionit. Autoriteti mund të lejojë dhe të nxjerrë rregullore për kushtet, që duhet të përmbushë shoqëria administruese, në mënyrë që të kryejë veprimtari, të cilat janë të lidhura ngushtë me administrimin e fondit të pensionit, si administrimi i fondeve të investimeve dhe administrimi i aseteve, me kusht që shoqëria administruese të jetë e pajisur me licencën e duhur, për të kryer këto lloj veprimtarish.

Neni 21

Kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë administruese

1. Shoqëria administruese, në çdo kohë, duhet të ketë një kapital të paktën 15 625 000 lekë, i cili përbën dhe kapitalin themeltar të regjistruar. Kapitali i shoqërisë administruese llogaritet duke zbritur në bilancin e shoqërisë administruese detyrimet nga asetet.

2. Kur vlera neto e aseteve në fondet e pensionit, të administruara nga shoqëria administruese, e kalon vlerën 31 250 000 000 lekë, shoqëria administruese duhet ta rrisë kapitalin, në mënyrë që shtesa e kapitalit të jetë të paktën e barabartë me 0,02 për qind të vlerës, me të cilën vlera neto e aseteve të fondeve të administruara kalon pragun e përmendur në këtë pikë. Megjithatë, nuk është e nevojshme që kapitali të kalojë vlerën 1 250 000 000 lekë.

3. Shoqëria administruese duhet të njoftojë menjëherë autoritetin nëse kapitali i saj bie nën nivelin e kërkuar, të përcaktuar në këtë nen.

4. Kapitali i kërkuar do të jetë në formën e mjeteve, të cilat përcaktohen të lejueshme për fondin e pensionit në nenin 63 të këtij ligji dhe në rregulloret në zbatim të tij. Vlerësimi i mjeteve, që përfshihen në përlllogaritjen e kapitalit, bëhet në përputhje me standardet e SNRF-së, përveçse kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e nxjerra nga autoriteti.

5. Nëse rregulloret për investimet, të miratuara sipas nenit 63 të këtij ligji, lejojnë të investohet në pasuri të paluajtshme, vlera e pasurisë së paluajtshme nuk duhet të kalojë 20 për qind të kapitalit të kërkuar të shoqërisë administruese dhe në përlllogaritje mund të përfshihen vetëm ato pasuri të paluajtshme, të cilat janë të

nevojshme për veprimtarinë e shoqërisë administruese.

Neni 22

Burimi i kapitalit aksionar

1. Çdo aksionar jep informacion për burimin e kapitalit, sipas kritereve të përcaktuara nga autoriteti.
2. Kapitali aksionar nuk përbëhet nga:
 - a) hua nga publiku;
 - b) kredi nga banka;
 - c) paradhënie apo hua nga subjekte e palë të treta.

Neni 23

Përdorimi i emrit “Shoqëri administruese e fondit të pensionit”

1. Emri i shoqërisë administruese duhet të përfshijë fjalët “Shoqëri administruese e fondit të pensionit”. Nëse shoqëria nuk licencohet si shoqëri administruese, ajo duhet që, brenda 2 muajve, të çregjistrojë emrin “Shoqëri administruese e fondit të pensionit”.
2. Emri i shoqërisë administruese nuk duhet të përmbajë fjalë, të cilat mund të keqorientojnë anëtarët, aktualë ose të ardhshëm, apo cilindo tjetër dhe emri nuk duhet të bëjë referenca, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që tregojnë se investimet janë të garantuara apo që shteti shqiptar është i përfshirë në këtë veprimtari.
3. Nëse shoqëria administruese synon të kryejë njëkohësisht veprimtarinë e administrimit të fondit të pensionit dhe veprimtarinë e administrimit të fondit të investimit duhet që këto veprimtari të kryhen të veçuara nga njëra-tjetra, sipas rregulloreve të autoritetit.
4. Autoriteti nxjerr rregullore për ndarjen e veprimtarisë së administrimit të fondit të pensionit nga veprimtaria e administrimit të fondit të investimit, të kryera nga e njëjta shoqëri administruese.

Neni 24

Kërkesat për licencimin e shoqërisë administruese

1. Shoqëria administruese nuk duhet të fillojë marketingun apo të lidhë kontratën e fondit të pensionit me asnjë individ para se të jetë licencuar nga autoriteti.
2. Aplikimi për dhënien e licencës për të vepruar si shoqëri administruese shoqërohet me:
 - a) dokumentet, që vërtetojnë se aplikanti është një shoqëri aksionare e regjistruar, statutin e shoqërisë dhe dokumentin, që vërteton se pjesët e kapitalit të kësaj shoqërie janë paguar plotësisht;
 - b) dokumentet, që vërtetojnë se shoqëria plotëson kërkesat e këtij ligji për mjaftueshmërinë e kapitalit, përfshirë burimin e kapitalit, bilancet financiare përkatëse, që vërtetojnë burimin e kapitalit të shoqërisë, si dhe një deklaratë të nënshkruar nga

këshilli i administrimit të shoqërive përkatëse, se bilancet pasqyrojnë realisht gjendjen e shoqërisë;

c) dokumentet, që vërtetojnë se aksionarët ndikues të shoqërisë, drejtorët, kontrolluesi kryesor, drejtori ekzekutiv, administratori dhe audituesi i brendshëm janë, individualisht e kolektivisht, të përshtatshëm e të aftë për të drejtuar këtë veprimtari. Dokumentet e nevojshme për të përcaktuar se këta persona i plotësojnë kërkesat për të qenë të përshtatshëm e të aftë, përfshijnë, të paktën:

i) diplomë arsimimi;

ii) CV-në e plotë, të nënshkruar, që tregon përvojën e mëparshme të personit dhe që përfshin emrat e kontaktet e personave, që mund ta vërtetojnë korrektësinë e informacionit që përmban CV-ja;

iii) deklaratën e nënshkruar individualisht nga çdo person, ku deklarohet se ndaj asnjërit prej tyre nuk është hapur ndonjë çështje penale, ose se nuk ka asnjë hetim penal të mbetur pezull ose në vazhdim.

Të paktën dy administratorë të shoqërisë administruese duhet të kenë kualifikimin dhe certifikata për programet e njohura nga autoriteti, që të vërtetojnë aftësinë profesionale në fushën e administrimit të fondeve të pensioneve. Autoriteti nxjerr rregullore për testimin e këtyre personave për njohuritë në fushën dhe në legjislacionin përkatës;

ç) planbiznesin e shoqërisë administruese, për një periudhë kohore jo më të vogël se pesë vjet, ku përshkruhen veprimtaria, që synon të zhvillojë aplikanti, mënyra se si do të plotësohen kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe se si do të zhvillohet biznesi i parashikuar. Planbiznesi duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për:

i) organizimin e shoqërisë, përfshirë informacionet për produktet ose shërbimet, që do të ofrohen nga aplikanti;

ii) planin e marketingut të shoqërisë;

iii) planin e veprimit të shoqërisë, përfshirë rregullat për raportimin e aplikantit, si për qëllime të organeve drejtuese të brendshme, edhe për autoritetin;

iv) planin financiar, përfshirë përshkrimin se si do të mbulohet kostoja e nisjes së biznesit e si do të plotësohen kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;

v) analizën e riskut, përfshirë përshkrimin se si aplikanti do t'i trajtojë risqet përkatëse, në veçanti, riskun operacional, riskun e kredisë, riskun e tregut, riskun e përputhshmërisë dhe riskun e reputacionit;

d) një paraqitje me shkrim të organizimit të aplikantit dhe, në mënyrë të veçantë, të kërkesave për:

i) funksionimin e auditimit të brendshëm;

ii) funksionimin e administrimit të riskut;

iii) sistemet e brendshme të kontrollit, për përputhjen me politikat e procedurat e miratuara, si kodi i sjelljes për punonjësit;

iv) sistemet e teknologjisë së informacionit;

dh) projektkontratën dhe projektprospektin e fondit/fondeve të pensioneve, që do të administrohen sipas kërkesave të këtij ligji;

e) kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë administruese dhe një depozitari të licencuar, ku të përcaktohen detyrimet dhe të drejtat e palëve, sipas dispozitave të këtij ligji, e cila hyn në fuqi pas miratimit të licencës së shoqërisë administruese;

ë) një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit të aplikantit, nëse aplikanti është një filial i një institucioni të huaj financiar apo banke, që ka një licencë të

vlefshme për të dhënë shërbime financiare në vendin e huaj.

3. Autoriteti mund t'i kërkojë aplikantit informacione e dokumente shtesë, ose të kërkojë verifikimin e informacionit, nëse një gjë e tillë vlerësohet e nevojshme.

Neni 25

Kërkesa për përshtatshmëri dhe aftësi

1. Çdo person, i cili është ose do të jetë aksionar ndikues, drejtor, kontrollues kryesor, administrator ose auditues i jashtëm, në një shoqëri administruese ose të lidhur me një shoqëri të tillë, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i aftë për të mbajtur pozicionin e caktuar.

2. Në përcaktimin se një person është i përshtatshëm e i aftë të mbajë një pozicion të caktuar, autoriteti vlerëson nëse personi në fjalë ka:

a) integritetin, ndershmërinë dhe përkushtimin, për të përmbushur përgjegjësitë e pozicionit të vet;

b) kompetencën, aftësinë profesionale dhe gjykim të shëndoshë, për të përmbushur përgjegjësitë e pozicionit;

c) pavarësinë e duhur, që interesat e anëtarëve të të licencuarit ose të të licencuarit të propozuar nuk janë ose nuk mund të jenë në asnjë rast të kërcënuar nga konflikti i interesit, që mund të lindë nga personi, i cili e mban atë pozicion.

3. Përveç kërkesave të mësipërme, autoriteti vlerëson sjelljen dhe veprimtaritë e mëparshme të personit në fjalë, në biznes ose në çështje financiare dhe, në mënyrë të veçantë, heton nëse ka ndonjë të dhënë, që tregon se ky person ka qenë:

a) i dënuar për kryerje të veprave penale;

b) i përfshirë ose i lidhur me humbje financiare, për shkak të pandershmërisë, mungesës së aftësisë ose keqveprimit në kryerjen e shërbimeve financiare ose në administrimin e shoqërive të tjera;

c) i përfshirë në përvoja biznesi, si evazioni fiskal, të cilat autoriteti i vlerëson mashtruese, kërcënuese apo të papërshtatshme, pavarësisht nëse janë të ligjshme apo jo, por që gjithsesi sjellin diskreditim të mënyrës me të cilën ky person kryen shërbime financiare apo ndonjë veprimtari tjetër.

4. Individët, që kanë qenë të dënuar për ndonjë krim, nuk mund të jenë pronarë përfitues të një interesi kontrollues, të jenë drejtorë apo të mbajnë një pozicion drejtues në një shoqëri administruese. Për qëllime të kësaj pike, interes kontrollues do të thotë:

a) të jesh pronar i më shumë se 30 për qind të çdo kategorie të titujve, që kanë të drejtë vote;

b) të kesh pushtet për të zgjedhur shumicën e administratorëve të këshillit ose të drejtuesve të çdo organi politikëbërës;

c) të ushtrosh një ndikim kontrollues në drejtimin ose politikën e një shoqërie administruese.

5. Një aksionar ndikues, drejtor, kontrollues kryesor, drejtor ekzekutiv ose administrator i një shoqërie administruese nuk mund të jetë aksionar ndikues, drejtor, kontrollues kryesor, drejtor ekzekutiv ose administrator i depozitarit, që mban asetet e fondit të pensionit të shoqërisë administruese apo të një pale të lidhur me depozitarin.

Neni 26

Licencimi i shoqërisë administruese

Autoriteti jep licencën vetëm kur gjykon se aplikanti për licencën e shoqërisë administruese:

- a) plotëson kërkesat e këtij ligji për mjaftueshmërinë e kapitalit;
- b) çdo aksionar ndikues, drejtor, kontrollues kryesor, drejtor ekzekutiv, administrator dhe audituesi i brendshëm i shoqërisë është i përshtatshëm dhe i aftë, siç përcaktohet në nenin 25 të këtij ligji;
- c) ka aftësitë e duhura drejtuese, përfshirë teknologjinë e informacionit dhe garancitë operationale, për të vepruar në mënyrë të kujdesshme e të matur, në përputhje me të gjitha kërkesat e këtij ligji;
- ç) ka marrë të gjitha masat e duhura për mbajtjen e llogarive financiare e auditimin dhe do ta mbajë kontabilitetin financiar dhe dokumentacionin përkatës të veprimtarisë në mënyrë të kënaqshme, duke përdorur sisteme të përshtatshme kontrolli;
- d) emri i propozuar nga shoqëria administruese nuk keqorienton anëtarin, anëtarët potencialë ose cilindo tjetër, që ka marrëdhënie me të;
- dh) ka fonde të mjaftueshme për të mbijetuar dhe për të përmbushur kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë të gjithë veprimtarisë, përfshirë edhe periudhën kur veprimtaria nuk është fitimprurëse;
- e) zotohet me shkrim para autoritetit se do të veprojë gjithmonë në interesin më të mirë të anëtarëve.

Neni 27

Licenca e kushtëzuar

1. Autoriteti ka të drejtë që, në çastin e dhënies së licencës apo në çdo kohë të vendosë kushte për licencën përkatëse, të cilat i vlerëson se duhet të zbatohen, për të parandaluar shkeljet e këtij ligji ose të rregulloreve në zbatim të tij.

2. Licenca e kushtëzuar përmban kufizime që mund të lidhen me kohëzgjatjen e licencës dhe/ose me llojshmërinë e produkteve, që mund të ofrojë i licencuari. Autoriteti mund t'i kërkojë të licencuarit, pa asnjë kufizim:

- a) të ndërmarrë hapa të caktuar, për të mos lejuar ndjekjen e një drejtimi të caktuar veprimi ose për të ngushtuar qëllimin e veprimtarisë të të licencuarit në një mënyrë të caktuar;
- b) të ndalojë të promovojë veprimtarinë e tij në përgjithësi apo edhe te persona të veçantë a grupe personash, ose t'i kërkojë të licencuarit t'ua ofrojë shërbimet e veta financiare vetëm disa individëve ose individëve të përmendur në licencë;
- c) të mos hyjë në një transaksion të caktuar ose në lloje të caktuara transaksionesh;
- ç) t'i paraqesë, në çdo kohë, informacionin e dokumentet e përcaktuara në licencën e kushtëzuar.

Neni 28

Trajtimi i aplikimit për licencë

1. Licenca miratohet ose refuzohet nga autoriteti brenda tre muajve nga data e marrjes së aplikimit të plotë.
2. Autoriteti jep, me shkrim, arsyen kur refuzon ose kufizon licencën, duke dhënë një licencë të kushtëzuar, kur aplikanti kërkon një licencë më të gjerë.
3. Aplikanti mund të riaplikojë për licencë ose për një licencë më pak të kufizuar, kur i është refuzuar një licencë apo i është dhënë një licencë e kushtëzuar, më e kufizuar se ajo e kërkuar në aplikimin e parë.

Neni 29

Kohëzgjatja dhe natyra e licencës

1. Licenca e dhënë nga autoriteti, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është e vlefshme derisa autoriteti revokon licencën ose i licencuari heq dorë prej saj apo kur i mbaron afati kur licenca është e kushtëzuar.
2. I licencuari, pas marrjes së licencës, njofton me shkrim autoritetin, brenda 5 ditëve pune për çdo ndryshim material, që mund t'u bëjë informacioneve të dorëzuara.
3. Autoriteti rishikon ndryshimet e përshkruara në pikën 2 të këtij neni dhe vendos nëse shoqëria administruese i plotëson kushtet e licencës edhe pas ndryshimeve. Autoriteti mund ta revokojë licencën nëse vëren se shoqëria administruese nuk i plotëson më kushtet e licencës, si rezultat i ndryshimit.

Neni 30

Detyrat e administratorëve

1. Administratorët e një shoqërie administruese, gjatë administrimit të fondit të pensionit, duhet:
 - a) të zbatojnë procedura administrative të përshtatshme, përfshirë procedurat për delegimin e kompetencave, ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësisë;
 - b) të kontrollojnë e të zbatojnë masa mbrojtëse për përpunimin elektronik të të dhënave;
 - c) të kenë mekanizma të përshtatshëm, të brendshëm kontrolli, që të përfshijnë, veçanërisht, rregulla për:
 - i) tregtimin e titujve nga punëmarrësit për llogari të tyre;
 - ii) investimin e fondeve të veta;
 - iii) sigurimin se çdo transaksion i rishikuar, që ka të bëjë me një fond pensioni, mund të rindërtohet, duke nisur nga çasti fillestar i tij, nga palët në transaksion, nga natyra e tij, koha dhe vendi, në të cilin ai është prekur dhe se asetet e fondit të pensionit janë investuar në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me ligjin;
 - ç) të rishikojnë e të miratojnë parimet e mirëdrejtimit të shoqërisë, siç

rekomandohet nga funksioni i auditimit të brendshëm;

d) të sigurojnë se fondi i pensionit është i organizuar në mënyrë të tillë që të zvogëlojë sa më shumë rrezikun e një konflikti interesi, ndërmjet interesave të anëtarëve dhe shoqërisë administruese, administratorëve ose punonjësve të shoqërisë administruese apo një pale, të lidhur me këta persona, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

2. Çdo administrator i shoqërisë administruese duhet:

a) të veprojë ndershmërisht e me sinqeritet, duke pasur parasysh interesat më të mirë të fondit të pensionit dhe të anëtarëve;

b) të tregojë kujdesin, përkushtimin dhe të zotërojnë aftësinë e personit të matur, në rrethana të ngjashme;

c) të kryejë çdo detyrë tjetër, që parashikohet nga ligji për shoqëritë tregtare.

Neni 31

Auditi i brendshëm dhe administrimi i riskut

1. Shoqëria administruese duhet të ketë strukturat e auditit të brendshëm dhe të administrimit të riskut, me përmasa e aftësi të përshtatshme për veprimtarinë që ajo kryen.

2. Struktura e auditit të brendshëm dhe ajo e administrimit të riskut i raportojnë, drejtpërdrejt, këshillit të administrimit të të licencuarit.

3. Struktura e auditit të brendshëm është përgjegjëse:

a) për të rekomanduar parimet e mirëdrejtimit të shoqërisë, politikat dhe strategjitë për t'iu përmbajtur parimeve dhe për të vlerësuar çdo vit zbatimin e këtyre politikave e strategjive. Parimet e mirëdrejtimit të shoqërisë duhet të përfshijnë standardet e kryerjes së biznesit e të sjelljes etike të administratorëve, të drejtuesve e të personelit tjetër, politikat për transaksionet private, bërjen e marrëveshjeve me vetëveten dhe praktika të tjera transaksionesh, kur palët nuk janë të pavarura;

b) për të mbikëqyrur veprimet e shoqërisë administruese dhe për të dhënë udhëzime për të, në mënyrë të përditshme, për të siguruar se shoqëria u përmbahet objektivave e politikave të miratuara nga këshilli i administrimit dhe legjislacionit përkatës;

c) për të dhënë rekomandime për këshillin e administrimit, për rishikim dhe miratimin prej tij të objektivave, strategjive, planeve të biznesit dhe politikave madhore, që udhëheqin veprimin e institucionit;

ç) për t'i siguruar këshillit të administrimit informacionin përkatës, të hollësishëm e në kohën e duhur, në mënyrë që ky këshill të mund të rishikojë objektivat e biznesit, strategjinë e biznesit dhe politikat dhe për t'i bërë strukturat më të larta drejtuese përgjegjëse për pozicionin e tyre.

4. Struktura e administrimit të riskut është përgjegjëse që:

a) t'i rekomandojë këshillit të administrimit miratimin e një strukture të administrimit të riskut, që të identifikojë e të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme risqet, para të cilave janë të ekspozuara asetet e fondit të pensionit dhe shoqëria administruese, përfshirë, të paktën, riskun e tregut, riskun e kredisë, riskun operacional, riskun e reputacionit, riskun ligjor dhe riskun e agjencisë;

b) të mbikëqyrë veprimet e shoqërisë administruese dhe administrimin nga ana e

saj të fondit të pensionit dhe të japë udhëzime të përditshme, për të siguruar se shoqëria administruese, apo vetë dhe në rolin e administrimit të fondit të pensionit vepron brenda limiteve të riskut, të vendosura nga këshilli i administrimit dhe të shprehura në kontratën e fondit të pensionit dhe në prospekt.

Neni 32

Kërkesat për mbajtjen e llogarive financiare dhe auditimin e jashtëm

1. Shoqëria administruese duhet:
 - a) që llogaritë e veta dhe të fondit të pensionit që administrojnë t'i ketë të audituara çdo vit dhe në afate të tjera të ndërmjetme, siç kërkohet nga autoriteti. Audituesi i jashtëm duhet ta kryejë auditimin në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditit;
 - b) të mbajë në mënyrë të vazhdueshme dokumente të plota e të rregullta financiare dhe të përditësuara çdo muaj;
 - c) të përgatisë çdo vit, për vitin financiar të të licencuarit, pasqyrat financiare, në përputhje me SNRF-në, përveçse kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e nxjerra nga autoriteti;
 - ç) të përgatisë dhe të paraqesë, kur kjo shoqëri është filial, bilancin e saj vjetor të audituar dhe atë të konsoliduar.
2. Audituesi i jashtëm kontrollon dhe vërteton, nëpërmjet një raporti, sipas standardeve dhe procedurave profesionale, paraqitjen e vërtetë dhe ligjore të të paktën:
 - a) bilancit financiar, përfshirë shënimet në të;
 - b) llogarisë fitim-humbje, përfshirë shënimet në të;
 - c) raportit për asetet neto të fondit;
 - ç) raportit për ndryshimet në asetet neto të fondit;
 - d) raportit për kuotat e pensionit dhe strukturën e investimeve;
 - dh) veprimtarisë së kontrollit të brendshëm;
 - e) mbajtjes së regjistrave kontabël;
 - ë) vlerësimit të zërave të bilancit dhe atyre jashtë bilancit;
 - f) shpërndarjes së fitimit;
 - g) pasqyrës së qarkullimit të mjeteve monetare.
3. Autoriteti ka të drejtë t'ia kthejë raportin audituesit të jashtëm, nëse nuk është përgatitur në përputhje me pikën 2 të këtij neni, si dhe ka të drejtë të caktojë një auditues tjetër, të jashtëm, me shpenzimet e shoqërisë administruese, për ta hartuar raportin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 33

Auditimi i jashtëm

1. Shoqëria administruese emëron si auditues të jashtëm vetëm personat juridikë, të miratuar nga autoriteti.
2. Brenda tre muajve nga data e licencimit, në përputhje me këtë ligj, shoqëria administruese duhet të emërojë një auditues të jashtëm për të audituar llogaritë e saj.

3. Shoqëria administruese nuk mund të miratojë si auditues të jashtëm të saj një entitet, që ka drejtor, administrator, aksionar ose punonjës të saj një person me interes financiar në shoqërinë administruese dhe në njërin prej bizneseve të saj. Për qëllime të këtij neni, nuk vlerësohet interes financiar nëse është anëtar në fondin e pensionit.

4. Shoqëria administruese duhet të marrë miratimin e autoritetit për çdo ndryshim të audituesit të jashtëm të shoqërisë. Nëse emërimi i audituesit të jashtëm përfundon për çfarëdo arsye, audituesi i jashtëm duhet t'i paraqesë autoritetit një deklaratë, ku të shpjegojë, sipas audituesit të jashtëm, arsyen e përfundimit të detyrës dhe ta informojë me shkrim autoritetin për çdo çështje, që ka lidhje me shoqërinë administruese, për të cilat audituesi i jashtëm ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës dhe që, sipas mendimit të tij, mund të dëmtojë aftësinë e të licencuarit për të vepruar në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

5. Autoriteti nxjerr rregullore për kriteret dhe kërkesat për audituesin e jashtëm të shoqërive administruese.

Neni 34

Raportimi në autoritet

1. Nëse gjatë ushtrimit të kontrollit, audituesi i jashtëm vëren se shoqëria administruese ka shkelur rregullat e administrimit të riskut dhe, si pasojë, rrezikohen interesat e anëtarëve, likuiditeti apo vazhdimësia e veprimtarisë, informon menjëherë autoritetin.

2. Autoriteti ka të drejtë t'i kërkojë audituesit të jashtëm të shoqërisë administruese çdo informacion për veprimtarinë e tij. Audituesi i jashtëm është i çliruar nga sekreti profesional në dhënien e informacionit për autoritetin.

Neni 35

Publikimi i raportit të auditimit

1. Shoqëria administruese publikon në njërin nga botimet periodike financiare raportin e auditimit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.

2. Raporti i auditimit i publikuar përfshin të paktën bilancin vjetor, llogarinë fitim-humbje për shoqërinë administruese dhe fondet që ajo administron, si dhe mendimin e audituesit të jashtëm.

Neni 36

Mbajtja e dokumenteve

1. Shoqëria administruese është e detyruar të mbajë dokumentet e nevojshme për të paraqitur qartë e në mënyrë korrekte veprimtarinë, për të shpjeguar transaksionet dhe pozitën financiare të saj dhe për t'i dhënë mundësi autoritetit të përcaktojë nëse ajo është në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Dokumentet e kërkuara në pikën 1 të këtij neni ruhen për një periudhë jo më

të shkurtër se dhjetë vjet.

3. Ruajtja e dokumenteve bëhet në mënyrë të tillë që, kur të kërkohen, të mund të riprodhohen në formë të lexueshme.

Neni 37

Ndryshimi i kontrollit të shoqërisë administruese

1. Asnjë person nuk mund të bëhet aksionar ndikues ose kontrollues kryesor i shoqërisë administruese, përveç rasteve kur:

a) autoriteti ka dhënë miratimin me shkrim se është dakord që ai të bëhet aksionar ndikues ose kontrollues kryesor.

b) e ka njoftuar paraprakisht me shkrim autoritetin për qëllimin e tij.

Detyrimi i mësipërm për miratim nga autoriteti nuk është i domosdoshëm në rast se asnjë person nuk bëhet aksionar ndikues. Në këtë rast, në autoritet bëhet vetëm njoftimi përkatës.

2. Kur autoriteti njofton një person, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, se nuk ka kundërshtim që ai të bëhet aksionar ndikues i shoqërisë administruese, ose që të rrisë interesin e tij në shoqërinë administruese, mund të përcaktojë kufirin maksimal të interesit, që lejohet të arrijë ky person.

3. Autoriteti mund të kërkojë nga personi, që aplikon për t’u bërë aksionar ndikues, informacione dhe dokumente të mëtejshme, të cilat ai i gjykon të nevojshme.

4. Autoriteti vlerëson nëse personi është i përshtatshëm dhe i aftë, para se të japë miratimin për t’u bërë aksionar ndikues ose kontrollues kryesor.

5. Autoriteti i përgjigjet personit, që aplikon për t’u bërë aksionar ndikues ose kontrollues kryesor i shoqërisë administruese, brenda 3 muajve nga data e njoftimit të plotë nga aplikanti.

6. Afati i miratimit nga autoriteti për një aksionar ndikues, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përfundon brenda një viti nga data e miratimit, nëse personi nuk është bërë aksionar ndikues.

Neni 38

Kundërshtimi për aksionarin ndikues ose kontrolluesin kryesor ekzistues

1. Në rastet kur autoriteti ka të dhëna se një person, i cili është aksionar ndikues ose kontrollues kryesor i një shoqërie administruese, nuk i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë dhe të aftësisë, siç parashikohen në nenin 25 të këtij ligji, njofton me shkrim për kundërshtimin e tij, duke dhënë arsyet, të cilat çojnë autoritetin të mendojë se personi nuk është ose nuk është më i përshtatshëm edhe i aftë për të qenë aksionar ndikues ose kontrollues kryesor.

2. Autoritetit nuk i kërkohet ta përcaktojë, në njoftimin e nxjerrë, sipas pikës 1 të këtij neni, arsyen kur kjo, sipas mendimit të tij, çon në zbulimin e një informacioni konfidencial ose mund të dëmtojë një palë të tretë.

3. Para se të nxjerrë një njoftim, sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti i bën aksionarit ndikues ose kontrolluesin kryesor një njoftim paraprak, ku paraqet arsyet pse

ai mendon se personi nuk është i përshtatshëm për të qenë një aksionar ndikues apo kontrollues kryesor i të licencuarit.

4. Personi, që ka marrë njoftimin, sipas pikës 3 të këtij neni, brenda një periudhe prej 20 ditësh pune, mund të përgjigjet me shkrim për të dhënë arsyetimet e veta dhe autoriteti vlerëson çdo parashtrim me shkrim që ka marrë nga aksionari ndikues ose kontrolluesi kryesor. Autoriteti duhet të përgjigjet brenda 25 ditëve pune nga data e marrjes së përgjigjes me shkrim nga aksionari ndikues ose kontrolluesi kryesor, nëse mendon se ky aksionar ose kontrolluesi kryesor nuk është ose nuk është më personi i përshtatshëm dhe i aftë për të qenë aksionar ndikues apo kontrollues kryesor.

Neni 39

Kufizimet ndaj aksionarit ndikues dhe kontrolluesit kryesor, që nuk janë të përshtatshëm dhe të aftë

1. Kur një person është bërë ose vazhdon të jetë aksionar ndikues ose kontrollues kryesor, pa marrë lejen e nevojshme nga autoriteti, ky i fundit mund të urdhërojë që aksionet e tij, deri në një njoftim të mëtejshëm, t'i nënshtrohen kufizimeve të mëposhtme:

a) çdo transferim ose marrëveshje për transferim të aksioneve të aksionarit ndikues pezullohet;

b) asnjë e drejtë vote nuk mund të ushtrohet për aksionet;

c) asnjë pagesë e çfarëdo shume, që rrjedh nga aksionet, nuk duhet t'i bëhet aksionarit ndikues nga shoqëria administruese.

2. Autoriteti duhet të njoftojë shoqërinë administruese, kur ka mospërputhje me kërkesat e licencimit, për shkak se njëri nga aksionarët ndikues ose nga kontrolluesit kryesorë nuk janë të përshtatshëm dhe të aftë dhe kur licenca e saj mund të revokohet, sipas shkronjës “e” të pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji, përveç rastit kur ky aksionar shet një pjesë apo të gjitha aksionet që zotëron në shoqërinë administruese, sipas afateve të përcaktuara nga autoriteti.

Neni 40

Blerja, bashkimi dhe transferimi i shoqërisë administruese

1. Një shoqëri administruese, e licencuar sipas këtij ligji, mund të blejë dhe të zotërojë aksione në një shoqëri tjetër administruese vetëm kur blen dhe zotëron të gjitha aksionet e shoqërisë administruese të blerë. Blerja nga një shoqëri administruese e të gjitha aksioneve të një shoqërie tjetër administruese bëhet me miratimin paraprak, me shkrim, të autoritetit.

2. Ndryshimet në secilën prej dy shoqërive administruese, pas blerjes, që, për pasojë, shoqërohen me ndryshime në informacionin e dhënë autoritetit, në aplikimin për licencë, duhet të raportohen në mënyrën e duhur në autoritet, në përputhje me pikën 2 të nenit 29 të këtij ligji.

3. Shoqëria administruese, që pushon së ekzistuari, si pasojë e bashkimit me një shoqëri tjetër administruese, përpara përfundimit të veprimtarisë së saj, duhet të njoftojë anëtarët:

a) për mbylljen e veprimtarisë, duke u dhënë atyre tre muaj kohë për të ushtruar të drejtën për transferimin e aseteve të tyre në një fond tjetër pensioni, të administruar nga një shoqëri administruese tjetër, e zgjedhur sipas dëshirës së tyre;

b) nëse kërkon që ata të lidhin një kontratë të re fondi pensioni me shoqërinë e re administruese, të krijuar nga bashkimi, për të drejtën që ata kanë për të zgjedhur një shoqëri tjetër administruese ose për të kërkuar pagesë nga fondi i pensionit;

c) për pasojat e mundshme fiskale, që shkaktohen nga përfundimi dhe marrja e pagesës nga fondi i pensioneve, përpara arritjes së moshës së pensionit, përfshirë edhe mundësinë për të mos përfituar nga përjashtimi nga tatimet përkatëse;

ç) për çdo shpenzim që mund t'u ngarkohet atyre nga shoqëria, që ka pushuar së ekzistuari, të tilla si pagesa transanksioni, që do të mbulohen nga shoqëria administruese, e cila ka përthithur shoqërinë e mëparshme administruese.

4. Çdo anëtar, i cili nuk ka vendosur të lidhë një kontratë të re me shoqërinë e re administruese ose me ndonjë shoqëri tjetër administruese, mund të marrë pagesën përkatëse për të gjitha asetet që ka në fondin e pensioneve, por, në këtë rast, ky anëtar do të trajtohet sipas parashikimeve të neneve 88 pika 8 e 90 të këtij ligji.

Neni 41

Përgjegjësia e shoqërisë administruese

1. Çdo shoqëri administruese është përgjegjëse për fondin e pensionit që administron dhe ndaj çdo anëtari për dëmet e shkaktuara nga neglizhenca për të kryer ose nga kryerja me neglizhencë e detyrimeve të saj, që kanë të bëjnë me administrimin dhe përfaqësimin e fondit përkatës të pensionit.

2. Shoqëria administruese mund të delegojë funksionet e veta, që kanë lidhje me teknologjinë e informacionit, të mbajtjes së llogarive, si dhe funksione të tjera, të ndryshme nga administrimi i fondeve, vetëm me miratimin me shkrim të autoritetit. Funksione të tjera të një rëndësie të veçantë, siç është administrimi i fondeve, nuk mund të delegohen. Delegimi të një palë e tretë i disa funksioneve të caktuara të shoqërisë administruese nuk kufizon përgjegjësinë e kësaj shoqërie për përmbushjen e funksionit të deleguar.

3. Autoriteti harton rregulla për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese.

Neni 42

Njoftimi i konfliktit të interesit

1. Administratori i shoqërisë administruese, i cili:

a) është palë në një kontratë ose në një kontratë të propozuar me shoqërinë administruese për fondin e pensionit;

b) është drejtor ose administrator i një entiteti, palë e një kontrate ose e një kontrate të propozuar me shoqërinë administruese për fondin e pensionit;

c) është bashkëpronar i një personi, palë në kontratë ose në një kontratë të propozuar me shoqërinë administruese për fondin e pensionit;

duhet të njoftojë, me shkrim, në mënyrë të plotë, marrëdhënien e tij me entitetin,

me të cilin shoqëria administruese synon të lidhë ose ka lidhur një kontratë. Personi, gjithashtu, duhet të sigurojë që ky përshkrim të futet në procesverbalin e mbledhjes së këshillit të administrimit dhe të përfshihet në njoftimet, që u bëhen anëtarëve, së bashku me njoftimet për vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit, në përputhje me pikën 1 të nenit 14 të këtij ligji.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni bëhet nga administratori:

a) në mbledhjen e këshillit të administrimit, gjatë së cilës është shqyrtuar për herë të parë kontrata e propozuar;

b) nëse ai nuk ka pasur interes në kontratën e propozuar, në mbledhjen e parë, pasi administratori ka filluar të ketë interes në kontratën e propozuar;

c) në rast se administratori ka interes pas lidhjes së kontratës, atëherë në mbledhjen e parë, pasi ka nisur interesi;

ç) në rastet kur një person, i cili ka interes në një kontratë, bëhet më vonë administrator, atëherë në mbledhjen e parë, pasi ky person bëhet administrator.

3. Në rastin e administratorit, i cili nuk është anëtar i këshillit të administrimit, njoftimi i kërkuar në pikën 1 të këtij neni bëhet:

a) menjëherë pasi administratori merr dijeni se duhet të shqyrtohet një kontratë e propozuar ose se kontrata është shqyrtuar në mbledhjen e këshillit të administrimit;

b) menjëherë pasi administratori, pas lidhjes së kontratës, bëhet i interesuar;

c) nëse një person, i cili ka interes në një kontratë, bëhet më vonë administrator, menjëherë pasi të jetë bërë administrator.

4. Dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare për konfliktin e interesit janë të zbatueshme për shoqëritë administruese.

Neni 43

Detyrimi për abstenim

1. Në rastet kur për administratorin zbatohet pika 1 e nenit 42 të këtij ligji, në lidhje me një kontratë të caktuar, ai nuk duhet të jetë i pranishëm në mbledhjen e këshillit të administrimit, ndërkohë që shqyrtohet kontrata ose votohet për të.

2. Administratori, që vepron në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk duhet të mbajë më postin e administratorit dhe nuk ka të drejtë të zgjidhet apo të emërohet administrator në asnjë institucion të mbikëqyrur nga autoriteti, për një periudhë 5-vjeçare nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 44

Kufizime për transaksionet ndërmjet palëve të lidhura

1. Shoqëria administruese, gjatë administrimit të aseteve të fondit të pensionit që administron, nuk duhet të japë kushte më të favorshme për palët e lidhura.

2. Për qëllime të këtij neni, “dhënia e kushteve më të favorshme” nënkupton:

a) kryerjen e një veprimtarie, e cila nga natyra, qëllimi, karakteristikat ose rreziku nuk do të kryhej nga shoqëria me klientë të tjerë;

b) mbledhjen e interesave të tarifave ose shpenzimeve të tjera a pranimin e garancive më të ulëta apo pagimin e një interesi më të lartë se ai që kërkohet ndaj

klientëve të tjerë.

3. Asetet e fondit të pensionit nuk mund të shiten, të jepen hua ose të përdoren si garanci për detyrime, në favor të:

a) shoqërisë administruese, që administron asetet e tij ose të depozitarit, që ruan asetet e tij;

b) punëdhënësit, për të cilin fondi i pensionit është fondi i pensionit, i përcaktuar sipas planit profesional të pensionit;

c) çdo personi, i cili është palë e lidhur me personat juridikë të përcaktuar në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike.

4. Shoqëria administruese nuk lejohet të përdorë asetet e fondit të pensionit që administron për të blerë asete të tjera, të japë hua ose të marrë përsipër ndonjë detyrim, në favor të ndonjë personi juridik, të përmendur në pikën 3 të këtij neni.

KREU IV

DEPOZITARI

Neni 45

Roli i depozitarit

1. Depozitari i përcaktuar nga shoqëria administruese është përgjegjës për ruajtjen e aseteve të fondit të pensionit.

2. Asetet e fondit të pensionit, përfshirë mjetet monetare, duhet të mbahen te një depozitar i vetëm.

3. Depozitari duhet të mbajë asetet, veprimet dhe dokumentet e çdo fondi pensioni, për të cilin kryen shërbimin e depozitarit, të ndara nga njëra-tjetra dhe nga mjetet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.

Neni 46

Funksionet e depozitarit

1. Depozitari llogarit vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit dhe informon shoqërinë administruese, jo më rrallë se një herë në 30 ditë, për vlerën neto të aseteve të anëtarëve të fondit të pensionit.

2. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të fondit të pensionit nga shoqëria administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës së fondit të pensionit dhe të legjislacionit në fuqi. Depozitari nuk duhet të kryejë asnjë veprim të kërkuar nga shoqëria administruese, që bie në kundërshtim me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.

3. Depozitari siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të pensionit, t'i kthehet fondit të pensioneve çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara.

4. Depozitari siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit shpërndahen në përputhje me kontratën e fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi.

Licencimi i depozitarit

1. Depozitari duhet të licencohet nga autoriteti si depozitar i fondit të pensionit, përpara se të fillojë veprimtarinë e tij si i tillë. Vetëm bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit, mund të licencohen nga autoriteti për të kryer veprimtarinë e depozitarit të fondit të pensionit.

2. Për të marrë licencën e depozitarit nga autoriteti, banka duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme dhe të dorëzojë pranë autoritetit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues i bankës, ku përcaktohet se banka përmbush të gjitha kërkesat financiare, të përcaktuara në legjislacionin bankar dhe në të gjithë legjislacionin në fuqi;

b) deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues, ku përcaktohet se banka, gjatë kohës që është e licencuar, nuk zotëron dhe nuk do të zotërojë aksione në një shoqëri administruese ose aksione të ndonjë personi, që është palë e lidhur me këtë shoqëri administruese, apo se nuk do ketë marrëdhënie të tjera financiare me këta persona;

c) deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues, ku përcaktohet se banka, gjatë kohës që është e licencuar, nuk do të japë hua ose nuk do të marrë borxh nga shoqëria administruese, që administron asetet e fondit të pensionit, për të cilat vepron në cilësinë e depozitarit, ose nga ndonjë palë tjetër e lidhur;

ç) deklaratën e nënshkruar nga këshilli drejtues, ku përcaktohet se banka nuk ka dhe nuk do të ketë, gjatë kohës që është e licencuar, ndonjë punëmarrës ose anëtar të drejtorisë apo këshillit drejtues, të cilët janë:

i) anëtarë të këshillit të administrimit ose punëmarrës të shoqërisë administruese, që administron fondin e pensionit, asetet e të cilit ruan;

ii) anëtarë të këshillit të administrimit ose punëmarrës të çdo pale të lidhur me shoqërinë administruese, e cila administron fondin e pensionit, asetet e së cilës ruan.

3. Banka, gjithashtu, duhet të bindë autoritetin se është e aftë:

a) të sigurojë se llogaritja, konvertimi dhe tërheqja e kuotave të pensionit, në emër të shoqërisë administruese, janë në përputhje me ligjin dhe kontratën e fondit të pensionit;

b) të sigurojë se vlera neto e aseteve të kuotave të fondit të pensionit është llogaritur në përputhje me ligjin dhe me kontratën e fondit të pensionit;

c) të përmbushë udhëzimet e shoqërisë administruese dhe të refuzojë udhëzimet që janë në kundërshtim me ligjin dhe me kontratën e fondit të pensionit.

Revokimi i licencës, mospërmbushja e detyrimeve të depozitarit

1. Kur autoriteti revokon licencën e depozitarit, duhet të njoftojë shoqërinë administruese dhe Bankën e Shqipërisë.

2. Në rastet e çdo mospërmbushjeje të rëndësishme ose përmbushjeje jo si duhet të detyrimeve nga depozitari të kontratës ose në rastet kur depozitari është në procedura likuidimi, të detyruar ose vullnetar:

a) shoqëria administruese duhet të njoftojë menjëherë depozitarin, për të zgjidhur kontratën, si dhe autoritetin, për këtë zgjidhje;

b) shoqëria administruese duhet të caktojë një tjetër depozitar, brenda një kohe të arsyeshme.

Në rastet kur shoqëria administruese nuk ndjek hapat e përshkruar në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike, autoriteti mund ta urdhërojë atë të ndryshojë depozitarin.

3. Banka e Shqipërisë dhe çdo organ tjetër rregullator përkatës duhet të njoftojnë autoritetin për çdo informacion, për të cilin ka marrë dijeni, që është tregues i përkeqësimit të gjendjes financiare apo të strukturës organizative të bankës, që kryen veprimtarinë e depozitarit.

Neni 49

Përdorimi i nëndepozitarit

1. Depozitari mund të kontraktojë një nëndepozitar, me miratimin me shkrim të autoritetit dhe me marrëveshje me shoqërinë administruese, nëse është e nevojshme për investimet jashtë territorit të Shqipërisë. Një marrëveshje e tillë nuk kufizon përgjegjësitë ligjore të depozitarit dhe çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

2. Autoriteti mund të nxjerrë rregullore për kushtet që duhet të përmbushë nëndepozitari.

Neni 50

Ndryshimi i depozitarit

1. Shoqëria administruese, me miratimin e autoritetit, mund të ndryshojë mbajtjen e aseteve të fondit të pensionit nga një depozitar te një depozitar tjetër.

2. Ndryshimi i depozitarit bëhet në mënyrë që të mos pengojë vazhdimësinë e përmbushjes së detyrave të depozitarit për asetet e fondit të pensionit. Ndryshimi i depozitarit i njoftohet çdo anëtar i nga shoqëria administruese.

3. Në rastet kur kontrata me depozitarin është zgjidhur, depozitari duhet të dorëzojë të gjitha asetet e fondit të pensionit, që ka në ruajtje, si dhe të gjithë dokumentacionin për përmbushjen e detyrave të tij te depozitari i ri, brenda një kohe, për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve dhe pa vonesa të pajustificuara. Depozitari fillestar është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të tij deri në çastin që i gjithë dokumentacioni dhe asetet janë transferuar plotësisht.

Neni 51

Detyrimi i depozitarit për të informuar autoritetin

Depozitari duhet të informojë menjëherë autoritetin për çdo çështje, që gjykon se cilësohet si një veprim ose mosveprim, që mund të përbëjë shkelje të legjislacionit, të kontratës së fondit të pensionit ose të kërcënojë interesin e anëtarëve.

Neni 52

Mbrojtja e asetëve të fondit të pensionit

Asetet e fondit të pensionit, të depozituara në përputhje me dispozitat e këtij kreu, nuk mund t'u nënshtrohen ekzekutimeve për detyrimet që depozitari ka ndaj të tretëve. Asetet e fondit të pensionit duhet të veçohen nga asetet e depozitarit, në bazë të së drejtës së veçimit në procedurë falimentimi dhe nuk përfshihen në shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve të depozitarit.

KREU V

PLANI I PENSIONIT PROFESIONAL

Neni 53

Krijimi i planit të pensionit profesional

1. Punëdhënësi mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punëmarrësit e tij, duke lidhur një kontratë me shoqërinë administruese, që do ta ofrojë fondin e pensionit për punëmarrësit e tij.

2. Punëdhënësi mund të marrë përsipër detyrimin për të paguar kontribute për planin e pensionit profesional, duke:

a) kontribuar në emër dhe në favor të punëmarrësve;

b) i bërë një ose disa pagesa të rregullta shoqërisë administruese, për të mbuluar tarifat e kësaj shoqërie, që në rast të kundërt duhet të paguheshin nga anëtari.

3. Çdo kontribut i paguar nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit vlerësohet sikur është paguar nga vetë punëmarrësi.

4. Punëmarrësi hyn në fondin e pensionit profesional, pasi nënshkruan kontratën e fondit të pensionit profesional me shoqërinë administruese. Kontrata e fondit të pensionit profesional rregullon dhe detyrimin e punëdhënësit për të paguar kontributin.

5. Punëdhënësi mund të kufizojë të drejtën e anëtarit për kontributet e dhëna nga punëdhënësi, duke kërkuar që punëmarrësi të jetë i punësuar te punëdhënësi për një numër të caktuar vitesh, para se t'i njihet e drejta e kontributeve të punëdhënësit, në favor të tij.

6. Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet.

7. Kur punëdhënësi ndërpret marrëdhënien e punës me punëmarrësin, në mënyrë të njëanshme, pa shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkaqe të lidhura me punëmarrësin përpara periudhës së përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, kontributet e bëra nga punëdhënësi do t'i transferohen punëmarrësit.

Neni 54

Miratimi i planit të pensionit profesional

1. Funksionimi i planit të pensionit profesional mund të fillojë vetëm pasi ky plan të jetë miratuar nga autoriteti.
2. Kërkesa për miratimin e planit të pensionit profesional nga autoriteti duhet të shoqërohet edhe me:
 - a) kontratën e planit të pensionit profesional ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese;
 - b) një përshkrim të emrit dhe të karakteristikave të fondit të pensionit profesional dhe të shoqërisë administruese;
 - c) një përshkrim të emrit dhe të karakteristikave të punëdhënësit;
 - ç) kushtet e përzgjedhjes për të marrë pjesë në planin e pensionit profesional;
 - d) kontratën e fondit të pensionit profesional ndërmjet punëmarrësit dhe shoqërisë administruese;
 - dh) kufizimet mbi të drejtën e anëtarit për kontribute të menjëhershme nga punëdhënësi, si dhe kërkesën që punëmarrësi të qëndrojë i punësuar te punëdhënësi, për një numër të caktuar vitesh.
 - e) mënyrën e përcaktimit të tarifave, që punëdhënësi duhet t'i paguajë shoqërisë administruese;
 - ë) çdo kontribut minimal të mundshëm, të kërkuar për çdo kontribues;
 - f) procedurën e informimit të anëtarëve;
 - g) kushtet dhe procedurat për përfundimin e pjesëmarrjes dhe transferimin e asetëve të anëtarit në një fond tjetër pensioni;
 - gj) kushtet kur punëdhënësi mund të ndërpresë kontributin në shoqërinë administruese për punëmarrësit e tij.

Neni 55

Refuzimi i miratimit të kontratës së fondit të pensionit dhe të planit të pensionit profesional

Autoriteti refuzon miratimin e kontratës së fondit të pensionit ose të kontratës së planit të pensionit profesional apo ndonjë ndryshim të këtyre dokumenteve, nëse vëren se shoqëria administruese, depozitari, kontrata e fondit të pensionit profesional, prospekti ose kontrata e planit të pensionit profesional të planit të propozuar të pensionit profesional bien ndesh me kërkesat e këtij ligji ose të ligjeve të tjera të zbatueshme.

Neni 56

Punëmarrësi që nuk vazhdon marrëdhënien e punës

1. Nëse punëmarrësi ndërpret marrëdhënien e punës, ai mund të mbetet anëtar në fondin e pensionit. Nëse punëmarrësi vendos të mbetet anëtar, në kohën kur ndërpret marrëdhënien e punës, ai duhet të lidhë një kontratë të fondit të pensionit me shoqërinë administruese, e cila do të zëvendësojë kontratën e fondit të pensionit profesional, që

kishte punëmarrësi gjatë kohës që ka qenë i punësuar. Shoqëria administruese, e cila administron fondin e pensionit, nuk mund të refuzojë lidhjen e kontratës së fondit të pensionit me të njëjtat kushte si kontrata e mëparshme e planit të pensionit profesional me punëmarrësin.

2. Punëmarrësi, i cili ndërpret marrëdhënien e punës me punëdhënësin, mund t'i transferojë asetet e tij të mbledhura, sipas planit të pensionit profesional fillestar, te një fond tjetër pensioni, në përputhje me kërkesat e nenit 15 të këtij ligji.

Neni 57

Mosdiskriminimi

1. Pjesëmarrja në një fond pensioni profesional nuk duhet të kufizohet për punëmarrës të caktuar dhe duhet t'u ofrohet të gjithë punëmarrësve.

2. Një punëmarrës, si kusht për t'u punësuar ose për ndonjë qëllim tjetër, nuk mund të detyrohet të marrë pjesë apo të vazhdojë të marrë pjesë në kontratën e planit të pensionit profesional dhe pa miratimin me shkrim të punëmarrësit nuk mund të bëhet asnjë zbritje nga paga për kontributet në fondin e pensionit.

3. Anëtari mund të përfundojë, të zvogëlojë ose të rrisë kontributet në çdo kohë dhe këto ndryshime, në asnjë mënyrë, nuk duhet të ndikojnë në shumën e kredituar në llogarinë e tij, pavarësisht nëse kjo shumë është krijuar nga kontributet e bëra nga punëdhënësi apo nga punëmarrësi.

4. Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve të vet për mospagimin e ndonjë kontributi të parashikuar. Shuma e përgjegjësisë varet nga shumata e kontributeve, që nuk janë paguar ose nuk janë paguar plotësisht në fondin e pensionit, nga të ardhurat nga investimet, të parashikuara për periudhën në fjalë dhe nga çdo kosto, që mund të ketë punëmarrësi për të detyruar punëdhënësin të respektojë detyrimin e tij për të paguar kontributin.

Neni 58

Zbatimi i dispozitave të fondit të pensionit

Të gjitha dispozitat e këtij ligji, që rregullojnë fondin e pensionit, janë të zbatueshme edhe për fondin e pensionit profesional, për aq sa këto dispozita janë të zbatueshme.

KREU VI

AGJENTËT E FONDIT TË PENSIONIT

Neni 59

Licencimi i agjentit të fondit të pensionit

1. Asnjë person nuk mund të veprojë si agjent i fondit të pensionit, nëse nuk është licencuar nga autoriteti.
2. Personi, që vepron si agjent i fondit të pensionit, duhet të jetë tregtar ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe e krijuar sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
3. Autoriteti nxjerr rregullore për kriteret e licencimit të agjentit të fondit të pensionit.
4. Autoriteti i jep licencën një agjenti të fondit të pensionit vetëm nëse vëren se personi është i përshtatshëm dhe i aftë, sipas nenit 25 të këtij ligji.
5. Autoriteti revokon licencën e agjentit të fondit të pensionit, kur vëren se nuk është më i përshtatshëm dhe i aftë për të vepruar si agjent i fondit të pensionit dhe kur shkel dispozitat e këtij ligji.

Neni 60

Autorizimi i agjentit të fondit të pensionit

1. Agjenti i fondit të pensionit mund të lidhë kontrata të fondit të pensionit vetëm në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese, të licencuar nga autoriteti.
2. Agjenti i fondit të pensionit duhet t'u japë anëtarëve të mundshëm një certifikatë të lëshuar nga shoqëria administruese, e cila vërteton se ekziston një kontratë për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese, si dhe që shoqëria administruese është përgjegjëse për veprimet e kryera nga agjenti i fondit të pensionit, brenda qëllimit të kontratës.

Neni 61

Regjistri i agjentëve të fondit të pensionit

1. Shoqëria administruese mban regjistrin e agjentëve të fondeve të saj të pensionit. Regjistri duhet të jetë i përditësuar dhe i vihet në dispozicion autoritetit, për qëllime referimi dhe inspektimi.
2. Regjistri duhet të përmbajë emrin, selinë dhe të përshkruajë kompetencat e veçanta që duhet të ushtrojë, në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese, agjenti i fondit të pensionit.
3. Autoriteti mban regjistrin qendror të agjentëve dhe kërkon informacion të vazhdueshëm nga shoqëria administruese, me qëllim përditësimin e tij.

4. Shoqëria administruese duhet të informojë me shkrim autoritetin, menjëherë pas ndërprerjes së marrëdhënies me agjentin për heqjen e emrit të këtij agjenti të fondit të pensionit nga regjistri.

KREU VII

POLITIKAT E INVESTIMIT

Neni 62

Politikat e investimit dhe administrimi i riskut

1. Këshilli i administrimit miraton politikat e investimit, në përputhje me ligjin dhe rregulloret në zbatim të këtij ligji, mbikëqyr administrimin e investimeve të fondit të pensionit, siguron që përbërja dhe diversifikimi i tyre të përcaktohen në mënyrën e duhur në politikën e investimit. Politika e investimit, në kuptim të kësaj pike, përfshin:

- a) kufijtë për shumatat, që mund të mbahen në lloje të veçanta investimesh;
- b) përcaktimin e qartë të llojeve të instrumenteve financiare dhe të çdo aseti tjetër, në të cilin mund të investohet fondi i pensionit;
- c) rregulla për ruajtjen e aseteve të anëtarëve;
- ç) vlerësimin e përputhjes së duhur të aseteve dhe të detyrimeve;
- d) procedurën e duhur për mbikëqyrjen e nivelit të likuiditetit.

2. Këshilli i administrimit miraton sistemin e administrimit të riskut për fondin e pensionit, që përfshin përcaktimin dhe monitorimin e politikave, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin, në mënyrë të vazhdueshme, të të gjitha risqeve kryesore.

Neni 63

Investimet e lejuara

Asetet e fondit të pensionit mund të investohen vetëm në asete të përcaktuara në rregulloret e nxjerra për këtë qëllim nga autoriteti. Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, autoriteti nxjerr rregullore për aktivet e lejuara, në të cilat mund të investohet fondi i pensionit, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit.

Neni 64

Huamarrja

Shoqëria administruese ndalohej të marrë hua për kryerjen e investimeve për interes të fondit të pensionit ose për çdo qëllim tjetër, duke vënë si garanci asetet e fondit të pensionit.

Neni 65

Investimet e palejuara

1. Asetet e një fondi pensioni nuk mund të investohen në:
 - a) aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndërbankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës;
 - b) asete, që nuk mund të shiten ose transferohen;
 - c) instrumente derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit apo nga rreziqe të ngjashme;
 - ç) asete fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si antika, punime arti, mjete motorike etj.;
 - d) aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
 - i) çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - ii) depozitari i fondit të pensionit;
 - iii) çdo person, palë e lidhur me entitetet e radhitura në nënndarjet “i” dhe “ii” të kësaj shkronje;
 - dh) kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë shoqëria administruese;
 - e) letra borxhi, të emetuara nga vetë punëdhënësi.
2. Autoriteti nxjerr rregullore për investime të tjera të palejuara.

KREU VIII

MARKETINGU I FONDIT TË PENSIONIT

Neni 66

Ndalimi për keqinformim ose informacion të pavërtetë

1. Asnjë nga personat e mëposhtëm:
 - a) shoqëria administruese ose një person i lidhur me shoqërinë administruese;
 - b) punëdhënësi, që ka ngritur një fond pensioni profesional;
 - c) agjenti i fondit të pensionit ose punëmarrësi i personave të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike;nuk mund të përhapë ose të bëjë deklarata, që përmbajnë informacione të pavërteta, të keqinformojë apo të japë përshtypje të gabuar, me gojë a me shkrim, për një fond pensioni ose një shoqëri administruese.
2. Nëse autoriteti vlerëson se informacioni, që është lëshuar sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, me gojë ose me shkrim, për një fond pensioni apo një shoqëri administruese, është a mund të jetë keqinformues, ai mund ta ndalojë publikimin, shpërndarjen, si dhe urdhëron publikimin dhe rishpërndarjen e informacionit të korrigjuar, brenda një afati të caktuar kohe.

Neni 67

Veprimtari e padëshirueshme

1. Autoriteti mund të ndalojë një veprimtari të caktuar, duke e deklaruar si të padëshirueshme:

a) për të gjithë ose një kategori të veçantë fondesh pensioni ose planesh pensioni, përfshirë ato profesionale;

b) për të gjithë ose për një kategori të veçantë personash, që ofrojnë shërbime për fonde pensionesh apo plane pensionesh, përfshirë ato profesionale.

2. Kur autoriteti vëren se një person, që ofron shërbime për një fond pensioni, po zhvillon një veprimtari, e cila vlerësohet si veprimtari e padëshirueshme, mund të urdhërojë, menjëherë, pezullimin e kësaj veprimtarie për një periudhë kohore, që ai e vlerëson të nevojshme për të shqyrtuar çështjen, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, por jo më të gjatë se 3 muaj.

KREU IX

TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Neni 68

Informimi për tarifat e shoqërisë administruese

1. Të gjitha tarifat e zbatuara nga shoqëria administruese duhet të përfshihen në kontratën e fondit të pensionit, në prospekt dhe t'i bëhen të njohura çdokujt, që mendon të bëhet anëtar në fondin e pensionit. Shoqëria administruese duhet të përshkruajë qartë tarifin, që do të zbatohet dhe t'i paraqesë ato në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme nga njerëzit e zakonshëm.

2. Çdo rritje e tarifave të zbatuara nga shoqëria administruese duhet t'u njoftohet anëtarëve, të paktën, dymbëdhjetë muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

Neni 69

Zbatimi i tarifave

1. Shoqëria administruese mund të zbatohet tarifa vetëm në rastet dhe mënyrat e mëposhtme:

a) për koston e administrimit të fondit të pensionit, duke zbritur çdo vit një përqindje të caktuar të vlerës neto të aseteve të administruara. Përqindja e caktuar nuk mund të kalojë, në asnjë rast, 3 për qind në vit të vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit;

b) nëse asetet transferohen nga anëtarët e një fondi pensioni në një fond pensioni të ri, ose tërhiqen nga fondi i pensionit deri në 0,5 për qind të shumës së transferuar.

2. Autoriteti nxjerr rregullore që përcaktojnë më hollësisht elementet e koston së administrimit.

KREU X

MBIKËQYRJA

Neni 70

Objektivat e mbikëqyrjes

1. Autoriteti është i vetmi institucion që mbikëqyr veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
2. Objektivat e mbikëqyrjes janë:
 - a) mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe përfituesve;
 - b) sigurimi i zbatimit të dispozitave të këtij ligji për mbajtjen e sigurt, stabilitetin dhe parashikueshmërinë financiare të aseteve të fondit të pensionit;
 - c) forcimi i mirëqeverisjes, transparencës dhe parandalimi i sjelljeve të papërshtatshme apo mashtrimit nga ofruesit e shërbimeve për asetet e fondit të pensionit.

Neni 71

Ushtrimi i mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e veprimtarisë ushtrohet nëpërmjet:
 - a) analizës dokumentare;
 - b) inspektimit në vend, i cili mund të jetë i pjesshëm ose i plotë;
 - c) ndërhyrjes dhe zbatimit të masave të përcaktuara nga ky ligj.
2. Autoriteti, në kuadër të mbikëqyrjes, u kërkon të licencuarve çdo informacion dhe dokument, që ka lidhje me veprimtarinë e tyre.
3. Të licencuarit janë të detyruar t'i vënë në dispozicion autoritetit çdo dokument të kërkuar, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Autoriteti ushtron funksionet e veta mbikëqyrëse, duke përdorur përjasje me bazë risku dhe luan rol proaktiv, për shmangien e problemeve të rëndësishme, të mundshme, përpara se ato të ndodhin.
5. Autoriteti mund të hartojë metodologji dhe manuale në zbatim të pikës 4 të këtij neni.

Neni 72

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoriteti mund të lidhë kontrata ose të hyjë në marrëveshje mirëkuptimi me çdo autoritet mbikëqyrës, vendas apo të huaj, me mbikëqyrës të sektorit financiar, agjenci kundër pastrimit të parave apo çdo institucion tjetër, për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit.

2. Autoriteti mund të shkëmbejë me një autoritet tjetër mbikëqyrës, vendas ose të huaj:

- a) informacionin e kërkuar për subjektet e mbikëqyrura;
- b) të dhënat me karakter financiar;
- c) informacionin për individë, që mbajnë detyra me përgjegjësi në subjektet e mbikëqyrura.

3. Çdo informacion, dhënë një autoriteti tjetër mbikëqyrës, duhet të trajtohet si konfidencial nga autoriteti mbikëqyrës, që e merr informacionin dhe duhet të përdoret vetëm për qëllime mbikëqyrjeje.

4. Autoriteti që merr informacionin, para se të ndërmarrë çdo veprim të mëtejshëm, duhet të këshillohet me autoritetin.

Neni 73

Imuniteti dhe dëmshpërblimi i punonjësve të autoritetit

1. Anëtarët e bordit dhe punonjësit e autoritetit nuk mund të paditen në asnjë gjykatë për kryerje apo moskryerje të veprimeve gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara nga ky ligj, përveçse kur vërtetohet se ata kanë vepruar ose mosvepruar me keqdashje.

2. Autoriteti duhet të dëmshpërblejë anëtarët e bordit dhe punonjësit e autoritetit për çdo shpenzim ligjor, të bërë gjatë mbrojtjes ndaj proceseve ligjore të ndërmarra kundër tyre për veprimin ose mosveprimin e pretenduar të funksionit zyrtar, brenda qëllimit të punësimit, apo angazhimit të tyre, në bazë të këtij ligji, në kushtet kur ky person ka vepruar në mënyrë korrekte.

Neni 74

Konfidencialiteti

Autoriteti ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij, përveç rasteve të mëposhtme:

a) kur jepet pëlqimi i çdo personi dhe entiteti, që mund të identifikohet nga ky informacion;

b) kur autoriteti e gjykon të nevojshme për:

i) ushtrimin e funksioneve të veta;

ii) parandalimin dhe zbulimin e krimit;

iii) zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare;

iv) ndihmën ndaj çdo autoriteti mbikëqyrës, vendas apo të huaj, që ushtron funksione, që u korrespondojnë atyre të autoritetit.

Neni 75

Raportimi

1. Shoqëria administruese përgatit raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë për çdo vit kalendarik, të cilat ia paraqet autoritetit brenda 31 marsit të vitit pasardhës, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të këtij ligji.

2. Shoqëria administruese përgatit raporte financiare dhe raporte të tjera të veprimtarisë për periudha edhe më të shkurtra se viti kalendarik, në zbatim të akteve ligjore në fuqi dhe të rregulloreve të autoritetit.

3. Autoriteti mund të publikojë raportet e përmbledhura financiare të shoqërisë administruese, së bashku me një raport të shkurtuar të audituesit të jashtëm.

4. Shoqëria administruese raporton dhe depoziton në autoritet:

a) pasqyrat financiare, të audituara nga një shoqëri auditimi e jashtme, e pavarur dhe të nënshkruara nga një ekspert kontabël i licencuar, si për shoqërinë administruese dhe për fondin e pensionit që ajo administron;

b) tarifat e agjentëve, tarifat e depozitarit dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga autoriteti;

c) të dhëna të aksionarëve të shoqërisë administruese, përfshirë emrat dhe adresat e tyre, si dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin aksionar;

ç) emrat dhe shpërblimet për anëtarët e këshillit të administratorëve dhe tabelën e pagave të shoqërisë administruese;

d) çdo propozim për ndryshim të të dhënave në regjistrin tregtar;

dh) njoftimet për thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dhe vendimet e marra në të;

e) investimet e shoqërisë administruese;

ë) ndryshimin e strukturës së kapitalit;

f) materiale me karakter publicitar;

g) përmirësimin e planbiznesit;

gj) çdo informacion tjetër, që mund të kërkohet nga autoriteti.

5. Shoqëria administruese, që është filial, duhet të dorëzojë pranë autoritetit pasqyrën financiare të audituar dhe atë të konsoliduar, brenda katër muajve nga fundi i vitit financiar, përveçse kur autoriteti ka miratuar një zgjatje të këtij afati.

Neni 76

Shpeshhtësia e raportimit

Autoriteti nxjerr rregullore për formën, përmbajtjen, shpeshhtësinë dhe afatet e llogaridhënies së hollësishme të veprimtarisë së shoqërisë administruese. Autoriteti mund t'u kërkojë të licencuarve të paraqesin raporte shtesë, sipas formës dhe afateve të kërkuara prej tij.

Neni 77

E drejta për marrje informacioni dhe inspektim

1. Autoriteti, në zbatim të funksioneve të veta, mund të kërkojë informacion për periudha të caktuara kohore nga:

- a) shoqëria administruese, depozitari dhe agjenti i fondit të pensionit;
- b) çdo person, që është ose ka qenë aksionar i rëndësishëm i shoqërisë administruese apo i depozitarit;
- c) çdo person, që është ose ka qenë në funksione drejtuese, administrator, punëmarrës në shoqërinë administruese ose i depozitarit, si dhe agjent i fondit të pensionit;
- ç) çdo person, që është ose ka qenë kontrollues kryesor i shoqërisë administruese apo i depozitarit;
- d) shoqëria holding ose një filial apo një shoqëri tjetër, që është filial i shoqërisë holding të shoqërisë administruese ose të depozitarit.

2. Autoriteti ka, gjithashtu, të drejtën të kërkojë informacion ose prova të tjera nga individë, që nuk janë të punësuar apo që punojnë për shoqërinë administruese ose depozitarin, por që janë dëshmitarë të rëndësishëm të një shkeljeje apo shkeljeje të mundshme të ligjit ose të përfshirë në një transaksion që po heton autoriteti.

3. Gjatë ushtrimit të inspektimit në vend, autoritetit duhet t'i vihet në dispozicion çdo informacion i kërkuar, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

4. Inspektimet në vend mund të zhvillohen në çdonjërin apo në të gjitha vendet e ushtrimit të veprimtarisë ose atje ku mbahet çdo e dhënë nga shoqëria administruese dhe nga depozitari. Shoqëria administruese, depozitari dhe agjenti i fondit të pensionit duhet të sigurojnë që agjentët e tyre, çdo palë që vepron në bazë të një marrëveshje nënkontraktimi apo që vepron si përfaqësues, në emër të tyre, të lejojnë, në të njëjtën mënyrë, hyrjen e autoritetit në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 78

E drejta për të caktuar ekspert

1. Autoriteti mund të emërojë një ekspert ose persona të tjerë të kualifikuar profesionalisht, për të shqyrtuar, rishikuar dhe raportuar për një çështje të caktuar ose në përgjithësi, për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë administruese, librat e depozitarit, llogari dhe dokumente të tjera, para, tituj ose ndonjë pasuri tjetër të mbajtur në llogarinë e një personi tjetër, ose çdo çështje, që autoriteti gjykon se ka lidhje me funksionet e të licencuarit.

2. Personi i caktuar nga autoriteti, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, u nënshtrohet të njëjtave kërkesa konfidencialiteti, të cilave u nënshtrohen edhe vetë punonjësit e autoritetit.

3. Autoriteti nxjerr rregullore për kriteret dhe procedurat e emërimit të ekspertëve apo të personave të tjerë të kualifikuar profesionalisht.

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Shoqëria administruese, depozitari dhe agjenti i fondit të pensionit janë të detyruar t'i japin menjëherë autoritetit çdo informacion, që ata kanë, kur shoqëria administruese ose depozituesi janë në dijeni se kanë arsye të besojnë se:

a) informacioni është i përshtatshëm për ushtrimin nga autoriteti të detyrave të tij, sipas këtij ligji për shoqërinë administruese ose depozitarin;

b) mosdhënia e informacionit mund të sjellë, si pasojë, mashtrimin e autoritetit për ndonjë çështje, e cila është me rëndësi thelbësore për ushtrimin e atyre funksioneve, që lidhen me shoqërinë administruese ose depozitarin.

2. Shoqëria administruese dhe audituesi i saj i jashtëm kanë detyrimin të informojnë menjëherë autoritetin për çdo çështje, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se:

a) kjo shoqëri nuk është në gjendje ose mund të mos të jetë në gjendje në të ardhmen të përballojë detyrimet e saj, kur ato bëhen të kërkueshme ose kur detyrimet të kalojnë aktivet e saj;

b) kjo shoqëri nuk është në gjendje të përmbushë kërkesën për mjaftueshmërinë e kapitalit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji ose të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij;

c) gjendja ekzistuese e punëve ose ajo e propozuar mund të rrezikojë të drejtat e anëtarëve ose të konsumatorëve të tjerë të shoqërisë;

ç) në rastin e një audituesi të jashtëm, ai/ajo ka qëllim të bëjë një kualifikim thelbësor në raportin e tij drejtuar aksionarëve, për fondet e pensionit ose shoqërinë administruese.

KREU XI

MASAT PARANDALUESE DHE KORRIGJUESE

Kushtet dhe masat

1. Autoriteti merr masat parandaluese dhe korrigjuese të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse vëren se shoqëria administruese vetë dhe për llogari të fondit të pensionit që ajo administron ose depozitari:

a) është ose parashikohet të jetë i paaftë për të paguar detyrimet, kur ato bëhen të kërkueshme, për shkak të mungesës së likuiditetit të nevojshëm;

b) është ose parashikohet se do të jetë i paaftë për t'iu përgjigjur kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit për veprimtarinë e tij të licencuar;

c) nuk vazhdon të përmbushë një ose disa nga kërkesat fillestare për marrjen e licencës ose të miratimit;

ç) nëse çdo person, që është ose do të jetë aksionar ndikues, kontrollues kryesor,

anëtar i këshillit të administrimit, administrator ose auditues i jashtëm i të licencuarit nuk janë më të përshtatshëm dhe të aftë për të mbajtur një pozicion të veçantë;

d) është ose mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të rregulloreve të miratuara në zbatim të tij.

2. Autoriteti merr masat parandaluese dhe korrigjuese të mëposhtme ndaj shoqërisë administruese ose depozitarit të një fondi pensioni:

a) urdhëron të licencuarin të ndërmarrë veprime të nevojshme për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara në zbatim të tij;

b) kërkon nga i licencuari të hartojë një plan financiar për përmbushjen e kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit;

c) kërkon nga i licencuari kryerjen e një auditimi të veprimtarisë së të licencuarit, me shpenzimet e këtij të fundit, nga një auditues i zgjedhur nga autoriteti, shkarkimin e çdo audituesi të të licencuarit dhe emërimin e një tjetri, me afat të përcaktuar nga autoriteti;

ç) kërkon nga i licencuari, me shpenzimet e këtij të fundit, të emërojë një person që të këshillojë të licencuarin për veprimtarinë e tij dhe të raportojë pranë autoritetit, brenda tre muajve nga emërimi i këtij personi;

d) vendos të licencuarin nën administrim të veçantë, me shpenzimet e këtij të fundit, duke emëruar një person tjetër për të marrë kontrollin e veprimtarisë së të licencuarit. Administratori i veçantë i emëruar do të jetë nën kontroll të drejtpërdrejtë të autoritetit dhe, me kufizimet e nevojshme, do të ketë të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dhe të këshillit të administrimit të shoqërisë;

dh) pezullon, tërësisht ose pjesërisht, licencën e shoqërisë administruese, të depozitarit ose miratimin e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit;

e) revokon, tërësisht ose pjesërisht, licencën e shoqërisë administruese, depozitarit ose miratimin e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit.

3. Autoriteti mund të këshillojë të licencuarin të ndërmarrë veprime të caktuara ose të përshtasë një drejtim të caktuar veprimi, për sa kohë nuk shkelen dispozitat e këtij ligji.

Neni 81

Urdhrat

1. Urdhrat e dhënë nga autoriteti, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji, mund të përmbajnë të gjitha ose disa nga ndalimet dhe kërkesat e mëposhtme:

a) ndalon të licencuarin të shtrijë veprimtarinë te personat e një klase ose përshkrimi të caktuar apo te persona të ndryshëm nga kjo klasë ose përshkrim;

b) kërkon nga i licencuari të marrë ose e ndalon të ndërmarrë veprime të caktuara apo të përshtatë një drejtim të caktuar veprimi ose kufizon veprimtarinë e tij në një mënyrë të caktuar;

c) ndalon të licencuarin të hyjë në transaksione të caktuara ose në tipe të caktuara transaksionesh apo të hyjë në këto transaksione në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara;

ç) ndalon të licencuarin të shesë ose të transferojë asete, që i përkasin atij apo fondit të pensionit gjatë një periudhe të caktuar, a të transferojë asete nga Shqipëria gjatë një periudhe kohore, nëse ato ndodhen në Shqipëri;

d) kërkon nga i licencuari të mbajë në Shqipëri asete, me vlerën që gjykohet nga autoriteti si e nevojshme, për të përballuar nga i licencuari detyrimet e veprimtarisë së tij të licencuar;

dh) kërkon që i licencuari të transferojë kontrollin e aseteve të një klase ose të një përshkrimi të caktuar te personi i miratuar nga autoriteti;

e) ndalon të licencuarin, i cili është subjekt i të drejtave të personave të tretë, të paguajë ose të transferojë çfarëdolloj shume te çfarëdo personi apo të marrë përsipër detyrime të tilla;

ë) ndalon të licencuarin të ndërmarrë detyrime financiare, në emër dhe për llogari të personave të tretë;

f) ndalon të licencuarin të marrë hua, të paguajë dividendë dhe/ose të transferojë detyrime te një person që, për shkak të lidhjes me të licencuarit, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i aftë, sipas këtij ligji;

g) kërkon që i licencuari të zëvendësojë administratorin apo nëpunësin e tij;

gj) kërkon nga i licencuari të shkarkojë administratorin, kontrolluesin kryesor, nëpunësin e tij;

h) kërkon që aksionari ndikues të shesë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij në shoqërinë administruese, brenda një afati të caktuar nga autoriteti.

2. I licencuari, aksionari ndikues ose kontrolluesi kryesor duhet të zbatojnë urdhrat e dhënë nga autoriteti në bazë të këtij neni.

3. Urdhrat e dhënë në bazë të këtij neni do të zbatohen brenda afatit të përcaktuar si të nevojshëm nga autoriteti dhe ky afat mund të zgjatet, nëse është e domosdoshme.

4. Autoriteti, kur gjykohet e nevojshme, mund të shfuqizojë ose të ndryshojë urdhrin.

Neni 82

Kompetenca për të vendosur të licencuarin në administrim të veçantë

1. Autoriteti emëron një administrator të veçantë, në përputhje me shkronjën “d” të pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji, për të licencuarin, të cilit i jep atij kompetencat e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve dhe të këshillit të administratorëve.

2. Administratori i veçantë merr përsipër, nga data e emërimit, kontrollin dhe administrimin e të licencuarit.

3. Administratori i veçantë mund t'u kërkojë personave, të cilët kanë qenë më parë anëtarë të këshillit të administratorëve të të licencuarit, të dhëna ose dokumente të caktuara, që kanë lidhje me veprimtarinë e të licencuarit.

4. Autoriteti mund ta shkarkojë administratorin e veçantë nga posti në çdo çast.

Neni 83

Detyrat e administratorit të veçantë

1. Administratori i veçantë vepron nën kontrollin e autoritetit dhe ndjek urdhrat e dhënë prej tij.

2. Administratori i veçantë, brenda një periudhe të arsyeshme kohe nga marrja e

detyrës, nga çasti i fillimit të administrimit të të licencuarit ose të një pjese të veprimtarisë së tij, i dorëzon autoritetit raportin, ku përcakton veprimet që duhen ndërmarrë, me argumentet përkatëse.

3. Administratori i veçantë mund të këshillojë transferimin e tërë ose të një pjese të veprimtarisë së të licencuarit te një i licencuar tjetër, vazhdimin e veprimtarisë së të licencuarit pas një periudhe administrimi të veçantë, likuidimin e të licencuarit ose çdo veprim tjetër, që ai e vlerëson të përshtatshëm. Administratori i veçantë mund të këshillojë veprime të ndryshme për pjesë të ndryshme të veprimtarisë së të licencuarit.

4. Raporti i përgatitur nga administratori i veçantë duhet t'i bëhet i njohur publikut në faqen zyrtare elektronike të autoritetit ose në vende e mënyra të tjera, të përcaktuara nga autoriteti.

5. Administratori i veçantë përgatit planin e transferimit, nëse autoriteti urdhëron transferimin e të tërë ose të një pjese të veprimtarisë së të licencuarit te një i licencuar tjetër.

6. Kontrolli dhe administrimi i të licencuarit nga administratori i veçantë përfundojnë, nëse autoriteti vendos që kontrolli dhe administrimi i të licencuarit nuk janë më të nevojshëm.

7. Administratori i veçantë është financiarisht përgjegjës për çdo dëm ose humbje të shkaktuar ndaj të licencuarit apo ndaj çdo pale të tretë, nëse dëmi a humbja është shkaktuar nga mashtrimi, neglizhenca ose mosrespektimi me dashje i ligjit nga administratori i veçantë.

8. Autoriteti mund të nxjerrë rregulla shtesë për kompetencat dhe detyrimet e administratorit të veçantë, përfshirë edhe detyrimet e të licencuarit.

Neni 84

Pezullimi i licencës

1. Autoriteti, në përputhje me shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 80 të këtij ligji, mund të pezullojë licencën, në çdo kohë, nëse, duke u bazuar në faktet dhe të dhënat që ka në dispozicion, ka bindjen se i licencuari nuk përmbush më kërkesat e licencimit.

2. Pezullimit të licencës mund t'i shtohen dhe kushte të tjera, si më poshtë:

a) ndalimi i të licencuarit të kryejë çdo veprimtari, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të pezullimit;

b) masa të tjera, që autoriteti i vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të anëtarëve.

3. Nëse licenca është pezulluar dhe janë vënë kushte, pezullimi i saj hiqet vetëm pas plotësimit të kushteve.

Neni 85

Vlefshmëria e kontratave pas revokimit të licencës

Nëse autoriteti revokon licencën, ky revokim nuk prek vlefshmërinë e kontratave, që janë lidhur në mirëbesim me palë të treta, para ose pas revokimit.

Neni 86

Likuidimi dhe falimentimi i shoqërisë administruese

1. Likuidimi i shoqërive administruese rregullohet nga dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit të një institucioni të licencuar nuk do të pranohet nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, përveç rastit kur autoriteti ka dhënë miratimin për paraqitjen e kësaj kërkesë.
3. Për të vendosur nëse kërkesa duhet të paraqitet ose jo, autoriteti duhet të vlerësojë nëse është e mundur që i licencuari të rivendosë ekuilibrin financiar të shoqërisë dhe ta sjellë atë në përputhje me kërkesat përkatëse për mjaftueshmërinë e kapitalit.
4. Autoriteti ka të drejtën të dëgjohet për çdo mocion, urdhër apo vendim tjetër, që ka lidhje me procedurat e falimentimit të të licencuarit.
5. Falimentimi i shoqërive administruese rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar për falimentimin.
6. Në rast falimentimi të shoqërisë administruese, asetet e fondit të pensionit, që zotërohen nga anëtarët, do të trajtohen si çdo pasuri tjetër, që i nënshtrohet të drejtës së veçimit, sipas legjislacionit shqiptar për falimentimin.

KREU XII

ANKIMI I VENDIMEVE TË AUTORITETIT

Neni 87

E drejta për ankim

Vendimet e autoritetit janë objekt ankimimi në gjykatë.

KREU XIII

TATIMI

Neni 88

Lehtësitë tatimore të kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit

1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi.
2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese.
3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për

llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit.

4. Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, përveç rastit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni, të bëra sipas përcaktimit të pikave 1 e 3 të këtij neni, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 200 000 lekë dhe 15 për qind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.

5. Në rast se anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij neni, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250 000 lekë dhe 25 për qind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.

6. Blerja e kuotave të një fondi pensioni është shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja.

7. Shërbimet e ofruara nga depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

8. Tatimi, që shoqëron tërheqjen e parakohshme, është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes.

Neni 89

Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

Neni 90

Trajtimi fiskal i përfitimeve të marra nga anëtari

Çdo pagesë e marrë nga anëtari i fondit të pensionit, sipas përcaktimeve të neneve 16 e 18 të këtij ligji, tatohet me tatimin mbi të ardhurat personale.

Neni 91

Zbatimi

Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve, në zbatim të dispozitave të parashikuara në këtë kre.

KREU XIV

PARANDALIMI I KRIMIT FINANCIAR DHE PASTRIMIT TË PARAVE

Neni 92

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

1. Të gjithë të licencuarit në bazë të këtij ligji janë subjekte të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Autoriteti shkëmben informacion dhe bashkëpunon, me të gjitha mënyrat e nevojshme, me organet mbikëqyrëse, vendase ose të huaja, për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 93

Krimi financiar

Të licencuarit i raportojnë autoritetit menjëherë çdo të dhënë për një veprimtari kriminale, qoftë në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj, për të cilat dyshojnë se ka lidhje me përdorimin e të licencuarit ose të shërbimeve të ofruara prej tij.

KREU XV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, GJOBAT DHE VEPRAT PENALE

Neni 94

Shkelja e dispozitave për konfliktin e interesit

1. Shkelja nga administratori i kërkesave të neneve 42 e 43 të këtij ligji përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në dy vjet ose me të dyja dënimet.

Neni 95

Përdorimi i emërtimit “fond pensioni vullnetar” në kundërshtim me ligjin

1. Përdorimi, nga çdo person, i emërtimit “fond pensioni vullnetar” ose i fjalëve apo i shprehjeve të tilla, të ngjashme, për qëllim fitimi material, përbën vepër penale

dhe dënohet me gjobë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në dy vjet ose me të dyja dënimet.

Neni 96

Shkelja e dispozitave të dokumentimit të të dhënave

1. Shkelja nga administratori i një shoqërie administruese ose nga depozitari i kërkesave të nenit 36 të këtij ligji, për dokumentimin e të dhënave, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, nëse:

a) shkatërron, fsheh, heq pjesë ose ndryshon ndonjë dokument a llogari, që kërkohet të mbahet apo të ruhet sipas dispozitave të këtij ligji ose të rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij;

b) dërgon, përpiket të dërgojë ose bashkëpunon me persona të tjerë për të dërguar jashtë Shqipërisë dokumente a llogari për mashtrimin e të tjerëve ose për të ndaluar, vonuar a penguar autoritetin të shqyrtojë, të hetojë a të kontrollojë apo të ushtrojë ndonjë detyrim tjetër, sipas këtij ligji, apo rregulloreve të dala në zbatim të tij.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në dy vjet ose me të dyja dënimet.

Neni 97

Shkelja e dispozitave për njoftimin e ndryshimit të kontrollit

1. Mosdhënia e informacionit nga personi autoritetit, sipas parashikimeve të nenit 37 të këtij ligji, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në një vit ose me të dyja dënimet.

Neni 98

Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë

1. Organizimi dhe zhvillimi nga çdo person i një veprimtarie pa licencë ose pa miratimin e lëshuar nga autoriteti, sipas këtij ligji, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në pesë vjet ose me të dyja dënimet.

Neni 99

Mosparaqitja e raportit

1. Kryerja nga çdo person e veprimeve në kundërshtim me parashikimet e neneve 75, 76 ose 77 të këtij ligji, pasi ka marrë më parë vërejtje nga autoriteti, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në një vit ose me të dyja dënimet.

3. Çdo person që nuk paraqet para autoritetit, brenda afatit të përcaktuar, raportimin, informacionin ose dokumentin e kërkuar sipas këtij ligji ose sipas rregulloreve të miratuara në zbatim të këtij ligji, dënohet me gjobë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo ditë kalendarike vonesë.

Neni 100

Mosinformimi

1. Shkelja nga shoqëria administruese, depozitari ose audituesi, i detyrimit për të informuar autoritetin, sipas parashikimit të nenit 79 të këtij ligji, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në një vit ose me të dyja dënimet.

Neni 101

Shkelja e urdhrave të autoritetit

1. Moszbatimi nga i licencuari, aksionari ndikues ose kontrolluesi kryesor, pa arsye të mjaftueshme, i urdhrave të dhënë nga autoriteti, në bazë të nenit 81 të këtij ligji, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Kur kjo vepër ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim deri në dy vjet ose me të dyja dënimet.

Neni 102

Kundërvajtje administrative

1. Kur çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

2. Shkeljet administrative, shqyrtimi i tyre dhe vendosja e masave administrative janë kompetencë e autoritetit.

3. Administrimi i të ardhurave nga gjobat bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 103

Gjobat

1. Autoriteti, për çdo kundërvajtje administrative, dënon me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
2. Autoriteti, për personin fizik përgjegjës, përveç gjobës së vendosur në pikën 1 të këtij neni, ka të drejtë ta pezullojë atë nga posti për një periudhë të caktuar.

Neni 104

Përsëritja e kundërvajtjeve administrative

Në rast përsëritjeje të kundërvajtjes administrative, autoriteti i dyfishon sanksionet e parashikuara në nenin 103 të këtij ligji, si dhe mund të shkarkojë personin përgjegjës nga funksioni, që ai ka në shoqërinë administruese.

Neni 105

Ekzekutimi i vendimeve nga zyra e përmbartimit

1. Gjobat e vendosura për shkeljet, sipas dispozitave të këtij kreu, do të paguhen në një llogari bankare të caktuar nga autoriteti brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit nga autoriteti.
2. Shoqëria administruese dhe personi përgjegjës paguajnë një interes prej 0,01 për qind të gjobës për çdo ditë pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Gjoha e vënë sipas këtij ligji përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbartimit, në rastet kur nuk paguhet brenda afateve të parashikuara në këtë nen.

KREU XVI

TARIFAT E AUTORITETIT

Neni 106

Tarifat e veprimtarisë dhe tarifat e tjera

1. Shoqëria administruese dhe depozitari paguajnë tarifë mujore ndaj autoritetit, gjatë periudhës që licenca është në fuqi, brenda datës 10 të muajit pasardhës.
2. Përveç tarifës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shoqëria administruese dhe depozitari paguajnë tarifë për licencimin, miratimin dhe autorizimin.

3. Nëse kërkesa për licencim ose miratim refuzohet, tarifa e paguar nuk kthehet.

Neni 107

Përcaktimi i tarifave

1. Autoriteti nxjerr rregullore për elementet dhe madhësinë e tarifave për licencimin, miratimin, autorizimin, funksionimin dhe penalitetet për pagesat e vonuara.
2. Autoriteti mund të ndryshojë nivelin e tarifave në projektbuxhetin vjetor.

KREU XVII

DISPOZITA TË TJERA

Neni 108

Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, institutet ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, do të vazhdojnë funksionimin, sipas kushteve që kanë qenë të vlefshme në çastin e krijimit të tyre.

2. Institutet ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, duhet të paraqesin, sipas dispozitave të këtij ligji, kërkesën për licencë brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Vlefshmëria e licencave të instituteve ekzistuese të pensioneve, të licencuara në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, përfundon në datën që hyn në fuqi vendimi i autoritetit, që jep licencën sipas dispozitave të këtij ligji. Kur autoriteti refuzon dhënien e licencës, përcakton në vendim edhe afatin, brenda të cilit institutet ekzistuese të pensioneve duhet të mbyllin veprimtarinë e tyre.

4. Nëse institutet ekzistuese të pensioneve nuk aplikojnë për licencë, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, licenca e dhënë në përputhje me ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar, nuk është më e vlefshme. Autoriteti përcakton, me vendim, afatin, brenda të cilit institutet ekzistuese të pensioneve duhet të mbyllin veprimtarinë e tyre.

5. Autoriteti, në vendimin për mbylljen e veprimtarisë, urdhëron institutin e pensionit t’ia transferojë fondet e pensionit në administrim një shoqërie administruese të licencuar, sipas dispozitave të këtij ligji, me miratimin e çdo anëtarit. Anëtarët, të cilët nuk dëshirojnë t’i transferojnë asetet e tyre te shoqëria administruese, kanë të drejtë t’i tërheqin ato.

Neni 109

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 91 të këtij ligji.
2. Ngarkohet autoriteti që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 63 të këtij ligji dhe brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 110

Përfundime

Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për fondin e pensionit, të krijuar sipas ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 111

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore, të nxjerrë në zbatim të tij, shfuqizohen.
2. Në ligjin nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të gjitha dispozitat, që parashikojnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e instituteve private të pensioneve suplementare, të cilat bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.
3. Shkronja “c” e nenit 2 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshohet si më poshtë:
“c) e tregut të pensioneve private dhe të veprimtarisë së këtij tregu;”.

Neni 112

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)